

RAPORT VJEŠTOR



2025

MISIONI

Të fuqizojmë profesionin e kontabilitetit dhe auditimit [në sektorin privat dhe publik] në Kosovë dhe regjion duke promovuar standardet më të larta të etikës, edukimit, dhe ekselencës profesionale për të mirën e shoqërisë si përfitues i fundit.

VIZIONI

Shoqatë lidere në avancimin e profesionit të kontabilitetit, auditimit dhe shërbimeve tjera të specializuara duke ofruar gjithmonë zgjedhjen më të mirë për profesionistët.

QËLLIMI

Zhvillimi i vazhdueshëm i programit të trajnimit i krahasueshëm me programet e shoqatave profesionale më eminente të kontabilitetit. Zhvillimi dhe avancimi i bazës së anëtarësisë të njohur për ekspertizë profesionale dhe standarde të larta etike. Anëtarësimi në organizata profesionale ndërkombëtare.

Anëtare me të drejta të plota në:



TEKNOLOGJIA SI MJET VLERAT SI MISION

Inteligjenca artificiale, automatizimi, analiza e avancuar e të dhënave dhe transformimi digjital nuk janë më koncepte të së ardhmes, ato janë realiteti i së tashmes. Në këtë kontekst të ndryshimit të shpejtë teknologjik, ShKÇAK qëndron e përkushtuar ndaj një parimi themelor: teknologjia është mjet, ndërsa vlerat profesionale janë misioni ynë.

Ky raport vjetor pasqyron angazhimin tonë për të udhëhequr profesionin përmes ndryshimit, duke ruajtur integritetin, etikën, transparencën dhe interesin publik si shtylla të patjetërsueshme. Inteligjenca artificiale po riformëson mënyrën se si përpunohen të dhënat, si analizohen rreziqet, si rritet efikasiteti operacional dhe si përmirësohet cilësia e raportimit financiar. Megjithatë, asnjë algoritëm nuk mund të zëvendësojë gjykimin profesional, përgjegjësinë etike dhe besimin publik që ndërtohet mbi standarde dhe vlera.

Gjatë këtij viti, ShKÇAK ka investuar në edukimin e vazhdueshëm profesional të anëtarëve të saj, duke integruar temat e inteligjencës artificiale dhe digjitalizimit. Qasja jonë ka qenë e balancuar të pajisim anëtarët me aftësi teknike bashkëkohore, pa komprometuar parimet bazë të profesionit. Në këtë mënyrë, ne synojmë të formojmë kontabilistë dhe auditorë profesionistë që jo vetëm dinë të përdorin teknologjinë, por edhe të kuptojnë kufijtë, rreziqet dhe implikimet etike të saj.

Raporti gjithashtu reflekton përpjekjet tona për të forcuar rolin e profesionit në shërbim të ekonomisë dhe shoqërisë. Në një mjedis ku vendimmarrja gjithnjë e më shumë mbështetet në të dhëna, përgjegjësia jonë për të garantuar besueshmërinë e informacionit financiar dhe jo-financiar bëhet edhe më e madhe. Inteligjenca artificiale na ndihmon të jemi më të shpejtë dhe më të saktë; vlerat profesionale na garantojnë që të jemi të drejtë, të pavarur dhe të përgjegjshëm.

“Teknologjia si mjet, vlerat si mision” - është një thirrje për reflektim dhe veprim. Ajo nënvizon bindjen tonë se progresi i qëndrueshëm nuk matet vetëm me nivelin e automatizimit apo sofistikimin e sistemeve, por me mënyrën se si këto mjete përdoren për të rritur besimin publik, për të mbrojtur interesin e përgjithshëm dhe për të ndërtuar institucione më të forta.

ShKÇAK do të vazhdojë të jetë një udhërrëfyes për profesionin në Epokën e Inteligjencës Artificiale, duke bashkuar inovacionin me etikën, dijen teknike me përgjegjësinë shoqërore, dhe ndryshimin me qëndrueshmërinë. Ky raport është dëshmi e këtij misioni dhe një angazhim për të ardhmen



PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----|
| FJALA E KRYETARIT | 001 |
| MESAZH NGA DREJTORESHA EKZEKUTIVE | 003 |
| AKTIVITETET E SHKÇAK GJATË VITIT 2025 | 005 |
| STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHKÇAK | 034 |
| STUDENTËT E VITIT 2025 | 035 |
| RAPORTET E KOMISIONEVE | 036 |
| RAPORT NGA KOMISIONI PËR NOMINIME | 037 |
| RAPORT NGA KOMISIONI PËR SJELLJE DHE DISIPLINË | 038 |
| RAPORT NGA KOMISIONI PËR EDUKIM DHE STANDARDE PROFESIONALE | 039 |
| RAPORT NGA KOMISIONI PËR MENAXHIM TË CILËSISË NË PAJTUESHMËRI ME STANDARDET | 040 |
| RAPORT NGA KOMISIONI PËR TATIME | 041 |
| STATISTIKAT 2025 | 042 |
| PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR | 046 |
| GALERIA | 047 |
| IN MEMORIAM | 051 |

SHKURTESAT

| | |
|-----------|--|
| AAT | Shoqata e Teknikëve të Kontabilitetit të Britanisë së Madhe |
| ACCA | Shoqata e Auditorëve të Çertifikuar të Anglisë |
| AICPA | Instituti Amerikan i Kontabilistëve Publik të Çertifikuar |
| AKK | Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve |
| ATK | Administrata Tatimore e Kosovës |
| BMP | Bordi i Mbikëqyrjes Publike |
| BQK | Banka Qendrore e Kosovës |
| CAP | Paneli Këshillues mbi Pajtueshmërinë e FNK |
| DOA (SMO) | Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë të FNK |
| EFAA | Federata Evropiane e Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM |
| FCM | Federata e Kontabilistëve të Mesdheut |
| FNK | Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve |
| IAAB | Instituti IAAB |
| IEKA | Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar |
| IFC | Korporata Financiare Ndërkombëtare |
| KPAP | Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale |
| KKRF | Këshilli Kosovar për Raportim Financiar |
| MFPT | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| MINT | Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë |
| NVM | Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme |
| OEAK | Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë |
| OEK | Oda Ekonomike e Kosovës |
| PAODC | Komisioni i FNK për Zhvillimin e Organizatave Profesionale të Kontabilitetit |
| PVM | Praktikat e Vogla dhe të Mesme |
| QRRF | Qendra për Reforma në Raportim Financiar |
| SNA | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit |
| SNE | Standardet Ndërkombëtare të Edukimit |
| SNK | Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit |
| SNRF | Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar |
| ShKÇAK | Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës |
| ZKA | Zyra Kombëtare e Auditimit |

Fjala e Kryetarit



Të nderuar anëtarë,

Është nder i veçantë t'ju drejtohem në kuadër të Raportit Vjetor, në një moment reflektimi mbi arritjet tona të përbashkëta dhe përgjegjësitë që kemi për të ardhmen e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë.

Për më shumë se dy dekada e gjysmë, ShKÇAK ka qenë një shtyllë themelore e cilësisë, etikës dhe përsosmërisë profesionale. Gjatë kësaj periudhe kemi ndërtuar themele të qëndrueshme, kemi avancuar profesionin dhe kemi avokuar vazhdimisht për transparencë dhe llogaridhënie në ekonominë e vendit. Në përputhje me orientimin strategjik të shoqatës dhe me fokus të veçantë tek anëtarët tanë, gjatë vitit të fundit kemi përmirësuar kushtet e ofrimit të shërbimeve në hapësirat e reja, kemi ofruar programe të reja certifikuese dhe kemi avancuar platformën digjitale të shërbimeve për anëtarët, duke rritur qasjen, efikasitetin dhe lehtësinë e përdorimit të shërbimeve tona. Si dëshmi e kontinuitetit dhe forcimit të qeverisjes së mirë korporative, kemi përzgjedhur Drejtoreshën e re Ekzekutive.

Ndryshimet teknologjike, përfshirë Inteligjencën Artificiale, po ndikojnë në mënyrën se si kryhen proceset rutinë dhe si menaxhohen të dhënat. Megjithatë, këto zhvillime nuk e zëvendësojnë profesionistin; ato na japin mundësi të fokusohemi më shumë në analiza, këshillim dhe krijimin e vlerës së shtuar për organizatat dhe institucionet që ne mbështesim. ShKÇAK mbetet e përkushtuar të udhëheqë këtë tranzicion përmes programeve profesionale të avancuara, edukimit të vazhdueshëm dhe bashkëpunimeve të zgjeruara ndërkombëtare, duke siguruar që praktikat dhe njohuritë më bashkëkohore të jenë të qasshme për të gjithë anëtarët tanë.

Në nivel ndërkombëtar, kemi avancuar bashkëpunimin e ShKÇAK duke u bërë anëtar i plotë i CFE Tax Advisers Europe, kemi marrë kryesimin si shoqatë e FCM, dhe kemi vazhduar me sukses prezencën dhe aktivitetin tonë në IFAC. Këto arritje forcojnë më tej pozicionin e profesionit tonë në skenën ndërkombëtare dhe krijojnë mundësi të reja për anëtarët tanë. Le të mbetemi të bashkuar rreth misionit tonë: të sigurojmë që profesioni i kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë të jetë modern, dinamik dhe i përgatitur për të ardhmen; të mbrojmë vlerat tona thelbësore – etikën, profesionalizmin dhe përgjegjësinë; dhe të udhëheqim me standarde të larta gjatë këtij tranzicioni të rëndësishëm

Në emrin tim dhe të Bordit të ShKÇAK, ju falënderoj për përkushtimin tuaj të palëkundur. Me bashkëpunim, vizion dhe integritet, do të vazhdojmë ta forcojmë rolin e profesionit në shoqëri dhe të ndërtojmë së bashku të ardhmen e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë.

ADRIAN ALO

Kryetar i Bordit të ShKÇAK

BORDI





Të nderuar anëtarë,

Pas 23 vitesh si Drejtoreshë Ekzekutive në ShKÇAK, ka ardhur koha që të hap një kapitull të ri profesional. Ndërsa largohem nga kjo detyrë, reflektoj mbi rrugëtimin tonë të përbashkët, sfidat dhe arritjet e shënuara ndër vite.

Udhëtimi im me ShKÇAK nisi në një periudhë kur Kosova ishte ende në rrugën e saj drejt konsolidimit si shteti më i ri në Evropë. Unë isha vetëm 30 vjeçe, me një vizion të qartë dhe një ekip të përkushtuar pranë dhe me vizionin për ta ndërtuar Shoqatën në një organizatë profesionale që do të shndërrohej në një pikë reference për çështjet që lidhen me ofrimin e shërbimeve të biznesit, standardet ndërkombëtare në kontabilitetit dhe auditimit, si dhe zhvillimin e mjedisit të biznesit në Kosovë.

Për më shumë se dy dekada, ShKÇAK ka bashkëpunuar ngushtë me të gjithë akterët relevantë: qeverinë, donatorët, rregullatorët dhe bizneset, duke promovuar me sukses rolin thelbësor të kontabilitetit, auditimit dhe menaxhimit financiar në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Gjatë kësaj kohe, organizata ka ofruar një gamë të gjerë programesh edukimi dhe certifikimi profesional. Ne kemi zgjeruar mundësitë e certifikimit si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, përfshirë fusha si forenzika financiare, auditimi i brendshëm, auditimi i IT-së, tatimet, ESG dhe insolvenca. Sot, anëtarët e ShKÇAK, pavarësisht sfidave ekonomike dhe politike, kontribuojnë çdo ditë në profesion, duke zbatuar në praktikë standardet ndërkombëtare të fituara përmes programeve tona.

Arritjet kanë qenë të shumta, por ndër më të spikaturat do të veçoja futjen e certifikimit të parë global për Institucionin Suprem të Auditimit në Kosovë, si dhe iniciimin e Departamentit të Kontabilitetit dhe Auditimit në Universitetin e Prishtinës.

Mesazhi i

Drejtoreshës

Përpjekjet tona për t'u afruar më shumë me komunitetin e biznesit, përfshirë anëtarësimin në odat ekonomike dhe lansimin e anëtarësimeve për biznese dhe individë, kanë forcuar më tej angazhimin tonë për të mbyllur boshllëqet e aftësive dhe për të përgatitur gjeneratat e ardhshme të profesionistëve për sukses.

Njohja ndërkombëtare e ShKÇAK, përmes anëtarësimin në organizata profesionale ndërkombëtare, ka ngritur profesionistët e Kosovës në skenën globale dhe ka ndihmuar në thyerjen e barrierave të njohjes ndërkombëtare të vendit. Sot, anëtarët e ShKÇAK i kalojnë provimet në programe që njihen globalisht, duke u bërë pjesë e komunitetit profesional ndërkombëtar. Siç kam thënë gjithmonë: jemi një ekipë e vogël profesionale, por me një zë të fuqishëm. Një nga objektivat e mia personale ka qenë gjithmonë inkurajimi i grave për të hyrë në një profesion që tradicionalisht është perceptuar si i dominuar nga burrat. Sot, gratë përbëjnë 55% të anëtarësisë sonë, një rritje e jashtëzakonshme nga 15% sa ishin në fillimet tona.

Me bindje të plotë mund të them se kemi bërë histori dhe kemi hapur rrugën për të tjerët, duke i fuqizuar që të ndihen të sigurt dhe të përkrahur në përpjekjet e tyre profesionale.

Arritja e përsosmërisë kërkon më shumë sesa aftësi teknike; ajo kërkon vizion të qartë, përkushtim të palëkundur dhe punë të palodhshme. Rrugëtimi im me ShKÇAK ka qenë dëshmi, duke treguar se kur këta elementë bashkohen, mund të arrihen rezultate të jashtëzakonshme.

Të gjithë juve që keni qenë pjesë e ShKÇAK, faleminderit nga zemra për besimin, mbështetjen dhe përkushtimin tuaj ndër vite.

ARDIANA BUNJAKU

Drejtoreshë Ekzekutive e ShKÇAK

ZYRA EKZEKUTIVE



AKTIVITETET E SHKÇAK, GJATË VITIT 2025

Shoqata edhe gjatë këtij viti ka vazhduar të implementojë programet e edukimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare, të mbajë anëtarët të përditësuar me zhvillimet më të fundit të profesionit përmes Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, si dhe të sigurojë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga anëtarët përmes Menaxhimit të Cilësisë. Një fokus i veçantë gjatë këtij viti ka qenë gjithashtu implementimi i digjitalizimit të proceseve të SHKÇAK.



Prioritet i ShKÇAK gjithmonë ka qenë dhe mbetet komunikimi me anëtarët. Ne i kushtojmë rëndësi të veçantë informimit të vazhdueshëm të tyre, duke përcjellë në kohë reale risitë, zhvillimet dhe ngjarjet më të rëndësishme që lidhen me profesionin, si në nivel vendi, ashtu edhe në rajon e më gjerë në arenën ndërkombëtare. Përmes këtij komunikimi aktiv, synojmë të krijojmë një lidhje të fortë bashkëpunimi me anëtarët dhe të rrisim transparencën.

Njëkohësisht, përditësimi i vazhdueshëm me standardet, praktikat më të mira, ndryshimet rregullatore dhe tendencat bashkëkohore të fushës, ju mundëson anëtarëve tanë të jenë më të përgatitur për sfidat e tregut dhe të ofrojnë shërbime me cilësi të lartë. Në këtë mënyrë, ShKÇAK kontribuon drejtpërdrejt në avansimin e profesionit në mënyrë të qëndrueshme, duke fuqizuar rolin e saj si në sektorin privat, ashtu edhe në sektorin publik, në funksion të rritjes së besueshmërisë, integritetit dhe standardeve profesionale në vend.

Si organi më i lartë qeverisës i Shoqatës, Kuvendi i përbërë nga anëtarët aktiv të ShKÇAK votoi dhe aprovoi me shumicë votash raportin e aktiviteteve dhe raportin e pasqyrave financiare të audituara për vitin 2024, Statutin e ShKÇAK, Strategjinë e zhvillimit 2025-2029, propozimin për investim në modulet e reja sipas Strategjisë së zhvillimit 2025-2029 si dhe planin e punës dhe buxhetin për vitin 2025.



Këtë vit u mbajtën edhe zgjedhje për anëtarët e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë, ku pas votimit nga Kuvendi u zgjodhën kandidatët si në vijim: znj. Ariana Alaj, znj. Aurora Dinaj, znj. Lyra Osmani Ahmeti dhe z.Ylli Llonçari

Gjatë Mbledhjes së Kuvendit të Anëtarëve të Shoqatës, Drejtoresha Ekzekutive përmes një fjalimi emocionues njoftoi anëtarët për vendimin e saj për dorëheqje nga pozita e Drejtorit Ekzekutiv. Znj. Bunjaku iu drejtua të pranishmëve duke reflektuar mbi rrugëtimin e përbashkët dhe duke i falënderuar për besimin, mbështetjen dhe bashkëpunimin gjatë 23 viteve të kaluara.

Kryetari i Shoqatës z. Adrian Alo, në emër të Bordit dhe anëtarëve falënderoi znj. Bunjaku për kontributin e dhënë në zhvillimin e shoqatës dhe të profesionit duke theksuar se gjatë gjithë këtij rrugëtimi, udhëheqja e saj ka qenë frymëzim për të gjithë. Përkushtimi i saj për të ndërtuar një organizatë mbi vlerat e besimit, ekselencës dhe bashkëpunimit ka lënë gjurmë të pashlyeshme dhe trashëgimia e saj do të na udhëheqë edhe në të ardhmen.

Ndërsa z. Burim Ahmeti në emër të Zyrës Ekzekutive falënderoi znj. Bunjaku për përkushtimin dhe angazhimin e pandërprerë, duke theksuar se puna e saj do të mbetet një frymëzim për të gjithë dhe kontributi i saj në zhvillimin e Zyrës Ekzekutive dhe personelit është një kapitull i rëndësishëm i historisë së ShKÇAK.





Shoqata vazhdon të ofrojë edukim cilësorë duke ju përgjigjur kërkesave të tregut në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit.

Zhvillimet e fundit në profesion janë nxitur nga globalizimi dhe avancimi teknologjik, duke sjellë njëkohësisht ndryshime në standarde, kërkesa më të larta për pajtueshmëri me legjislacionin, si dhe zbatimin e direktivave përkatëse.

Në kushtet e sfidave gjithnjë e më komplekse, është thelbësore që profesionistët të jenë vazhdimisht të informuar dhe të përditësuar me risitë më të fundit.

ShKÇAK, në mënyrë të vazhdueshme, angazhohet në përgatitjen e anëtarëve të saj për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale. Gjatë këtij viti, ShKÇAK ka përditësuar planprogramin për ta harmonizuar me ndryshimet më të reja në Standardet Ndërkombëtare, si dhe për të integruar aftësi dhe kompetenca të reja që kërkohen nga profesionistët. Ky angazhim siguron që anëtarët të jenë të përgatitur për të përmbushur kërkesat gjithnjë në rritje të ekonomisë dhe shoqërisë.



Gjatë këtij viti vëmendja është përqendruar edhe në hartimin dhe zhvillimin e moduleve specifike, të ndërtuara sipas kërkesave të tregut të punës, të cilat synojnë të përgatisin të rinjtë për një integrim sa më të suksesshëm profesional.

Në vitin 2025, ShKÇAK ka lansuar trajnimin e ri “BAZAT E ESG”, në bashkëpunim me Institutin Amerikan të Auditorëve të Çertifikuar – AICPA (SHBA). Ky program inovativ u mundëson pjesëmarrësve të kuptojnë rëndësinë e qëndrueshmërisë dhe standardeve ESG në kontekstin aktual. Pjesëmarrësit kanë përfituar certifikim të dyfishtë nga ShKÇAK dhe AICPA, duke rritur vlerën dhe njohjen ndërkombëtare të aftësive të tyre.



Në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP), anëtarët e ShKÇAK mbeten të përkushtuar për zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive dhe aftësive gjatë gjithë karrierës. Për këtë arsye, ruajtja, përmirësimi dhe avancimi sistematik i kompetencave është thelbësor për progresin profesional të çdo anëtari që mban thirrjet profesionale të ShKÇAK.

Shoqata, në mënyrë të pandërprerë, ofron sesione EVP me tema aktuale dhe relevante, të ndërtuara mbi nevojat e tregut dhe të profesionistëve, si dhe mbi zhvillimet dhe ndryshimet më të fundit ligjore dhe standardet e profesionit.

ShKÇAK ka vazhduar zbatimin e marrëveshjes me Zyrën Kombëtare të Auditimit për edukim të vazhdueshëm profesional. Përditësimi i njohurive të profesionistëve të këtij institucioni kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimin e menaxhimit të parashë publikë në institucionet shtetërore.



TEMAT E REALIZUARA GJATË VITIT 2025:

- DEKLARIMI TREMUJOR DHE VJETOR NGA BIZNESET INDIVIDUALE, KORPORATAT DHE INDIVIDËT; LIRIMET PËR TVSH; FURNIZIMI I MALLRAVE/SHËRBIMEVE DHE VENDI I FURNIZIMIT TË TYRE; FATURIMI DHE PERSONAT E OBLIGUESHËM PËR TË PAGUAR TVSH; TRAJTIMI I DONACIONEVE DHE SPONSORIZIMEVE SIPAS LEGJISLACIONIT TATIMOR;
- RAPORT NGA RISHIKIMI I AUDITIMEVE DHE PASQYRAVE FINANCIARE;
- STANDARDET E REJA TË PLOTA GLOBALE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
- APLIKIMI I SNRF PËR NVM NË KOSOVË; DALLIMET ME SNRF TË PLOTA, PRAKTIKAT MË TË MIRA;
- SNA 250 - KONSIDERIMI I LIGJEVE DHE RREGULLOREVE NË NJË AUDITIM TË PASQYRAVE FINANCIARE; SNA 540 - AUDITIMI I VLERËSIMEVE KONTABËL DHE SHPALOSJET PËRKATËSE; SNA 700 - FORMIMI I OPINIONIT DHE RAPORTIMI MBI PASQYRAT FINANCIARE;
- VENDIMMARRJET AFAT-SHKURTRA; ANALIZA E KOSTOS SË PRODUKTIT;
- PROCESI I BLERJES DHE BASHKIMIT TË NDËRMARRJEVE;
- BAZAT E RAPORTIMIT TË QËNDRUESHMËRISË-RAPORTIMIT ESG;
- SNRF 15 – TË ARDHURAT NGA KONTRATAT ME KLIENTËT; SNK 37 - PROVIZIONET, DETYRIMET KONTINGJENTE DHE PASURITË KONTINGJENTE; SNK 40 - PRONAT INVESTUESE
- SNRF 18 - PREZANTIMI DHE SHPALOSJET E PASQYRAVE FINANCIARE;
- STRATEGJITË PËR AUDITORËT E BRENDSHËM TË PUNËS NË TERREN DHE STRATEGJITË E TESTIMIT; PËRGATITJA E RAPORTIT TË AUDITIMIT;
- PËRGATITJA E LETRAVE TË PUNËS NË AUDITIM-RAST PRAKTIK;
- PARIMET THEMELORE TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE – DETYRIMET E PROFESIONISTËVE;
- KUPTIMI I KRIPTOMONEDHAVE – NJOHURI TË PËRGJITHSHME;
- TRANSFORMIMI DIGJITAL NË AUDITIM: PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË PËR PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE TË SIGURISË;
- NDËRTIMI I EKIPIT EFEKTIV TË PROFESIONISTËVE – AFTËSITË MENAXHERIALE;
- KONTABILITETI I SEKTORIT TË NDËRTIMTARISË: ASPEKTI TATIMOR DHE I RAPORTIMIT FINANCIAR.

Pajtueshmëria me Standardet Profesionale – vlerë e shtuar për anëtarët tanë

Gjatë vitit 2025, ShKÇAK përmes Menaxhimit të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standardet (MCSP) ka vazhduar të luajë një rol kyç në forcimin e cilësisë së shërbimeve profesionale të ofruara nga anëtarët e ShKÇAK. Përmes një kombinimi të rishikimeve profesionale, mbështetjes teknike, digjitalizimit të proceseve dhe komunikimit të vazhdueshëm me anëtarët, departamenti ka kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e pajtueshmërisë me standardet profesionale dhe në forcimin e besimit të publikut në profesion.

Fokusi kryesor gjatë vitit 2025 ka qenë sigurimi i një procesi funksional, transparent dhe të standardizuar të menaxhimit të cilësisë, duke ruajtur një qasje mbështetëse dhe edukative ndaj anëtarëve.

Një nga shtyllat kryesore të punës së MCPS gjatë vitit 2025 ka qenë menaxhimi dhe mbikëqyrja e procesit të raportimit vjetor të aktiviteteve të anëtarëve për vitin kontabël të përfunduar më 31.12.2024, përmes platformës elektronike të ShKÇAK.

Platforma elektronike është aktivizuar në qershor 2025 dhe ka qenë plotësisht funksionale për të gjitha kategoritë e anëtarëve: Auditorë Ligjorë (AL), Auditorë/Kontabilistë të Certifikuar (AC/KC) dhe Auditorë të Brendshëm të Certifikuar (ABC). Për të siguruar përfshirje sa më të gjerë dhe raportim korrekt, ShKÇAK ka zhvilluar udhëzime shtesë dhe video-udhëzuese për anëtarët që hasën vështirësi teknike apo procedurale gjatë raportimit.

Rezultatet e raportimit tregojnë një nivel të kënaqshëm pjesëmarrjeje, me rreth 83% të thirrjeve profesionale që kanë raportuar me sukses, duke reflektuar rritje të ndërgjegjësimit dhe përmirësim të disiplinës profesionale krahasuar me vitet e mëparshme. Për anëtarët që nuk kanë raportuar, janë ndjekur procedurat përkatëse sipas rregullores në fuqi.



Bazuar në të dhënat e raportuara dhe në metodologjinë e miratuar për përzgjedhje, gjatë vitit 2025 janë përzgjedhur anëtarë për rishikim të cilësisë për ciklin raportues 2024. Procesi i përzgjedhjes është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin për Menaxhimin e Cilësisë dhe Pajtueshmërinë me Standardet dhe është bazuar në kritere objektive, duke përfshirë vëllimin e angazhimeve dhe profilin e rrezikut.

Për Auditorët Ligjorë janë përzgjedhur dosje auditimi për rishikim të pajtueshmërisë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), ndërsa për Auditorët dhe Kontabilistët e Certifikuar janë përzgjedhur pasqyra financiare për rishikim të pajtueshmërisë me SNRF/SNK dhe SNRF për NVM.

Gjatë vitit 2025, është realizuar dhe ka vazhduar ciklin paraprak të rishikimeve të cilësisë, duke analizuar dokumentacionin e auditimit, raportet e auditimit dhe pasqyrat financiare të përgatitura nga anëtarët e përzgjedhur.

Rishikimet janë fokusuar në:

- planifikimin dhe dokumentimin e angazhimeve të auditimit,
- zbatimin e procedurave thelbësore,
- përgatitjen dhe shpalosjen e pasqyrave financiare,
- formulimin e raporteve profesionale dhe opinioneve.

Më konkretisht gjatë vitit 2025, janë finalizuar raportet e menaxhimit të cilësisë për Kontabilistët dhe Auditorët e Certifikuar (KC/AC) të përzgjedhur për rishikim nga cikli paraprak.

Pas përfundimit të procesit të rishikimit, draft raportet janë ndarë me anëtarët përkatës, nga të cilët janë pranuar komentet përkatëse. Anëtarët janë pajtuar me gjetjet e identifikuara dhe rekomandimet e dhëna. Raportet finale janë shqyrtuar dhe aprovuar nga Komisioni për Menaxhimin e Cilësisë dhe Pajtueshmërinë me Standardet, pas së cilës raportet e protokolluara u janë dërguar zyrtarisht anëtarëve përkatës.

Gjetjet kryesore lidhen kryesisht me paraqitjen dhe shpalosjen e pasqyrave financiare: paraqitjen e zërave me balancë zero dhe referenca të panevojshme në pasqyrat dhe shënime; mospërputhje të numrave referues dhe renditjes së shënimeve (shënime të ngatërruara, shënime që mungojnë ose nuk i përkasin zërit të referuar); mospërputhje vlerash ndërmjet pasqyrave bazë dhe shënimeve shpjeguese; formulime të paqarta për periudhën/datën në disa shpalosje; deklarata e pajtueshmërisë jo e plotë (p.sh. pa datë dhe/ose me vetëm një nënshkrim); mungesë shpalosjesh për tatimin në fitim në shënime; mungesë shpalosjesh për përfitimet e personelit kyç drejtues; shpalosje jo të plota për palët e ndërlidhura (sidomos mungesa e vitit krahasues); si dhe pasaktësi në kornizën e raportimit (përzjerje e SNRF për NVM me referenca/formate të SNRF/SNK të plota, ose shpalosje jo adekuate lidhur me standardet e reja dhe efektet e tyre).

Paralelisht, gjatë fundit të vitit 2025 është iniciuar edhe procesi i kontrollit të dosjeve të auditimit të Auditorëve Ligjorë të përzgjedhur për rishikim nga cikli paraprak. Ky proces është në vazhdim dhe raportet përkatëse pritet të finalizohen në ciklin pasues të raportimit.



Gjatë vitit 2025, është kontribuar edhe në aspektin edukativ dhe mbështetës për anëtarët, përmes organizimit të eventeve të zhvillimit profesional (EVP) të fokusuara në pajtueshmërinë me standardet profesionale dhe zhvillimet e fundit nga standard-vënësit ndërkombëtarë.

Një hap i rëndësishëm ka qenë edhe zhvillimi dhe lansimi i platformave digjitale mbështetëse, përfshirë:

- SCAAKSmartHub (<https://scaak-smarthub.netlify.app>), një platformë inovative që ofron asistencë profesionale përmes IA-së, mjete praktike dhe qasje të strukturuar në standarde dhe legjislacion,
- aplikacione mbështetëse për procese të brendshme dhe për koordinim të aktiviteteve edukative.

Këto iniciativa kanë synuar afrimin e standardeve me praktikën dhe rritjen e aksesit të anëtarëve në informacion cilësor dhe të besueshëm.

Si përfundim, gjatë vitit 2025, ShKÇAK përmes MCPS ka forcuar më tej rolin e saj si mekanizëm kyç për sigurimin e cilësisë profesionale. Përmes rishikimeve të strukturuar, mbështetjes edukative, digjitalizimit dhe komunikimit transparent me anëtarët, është kontribuar në rritjen e pajtueshmërisë me standardet profesionale dhe në forcimin e besueshmërisë së profesionit në përgjithësi. ShKÇAK mbetet e përkushtuar që edhe në vitet në vijim të avancojë proceset e menaxhimit të cilësisë, duke ndjekur praktikat më të mira ndërkombëtare dhe nevojat reale të anëtarëve të ShKÇAK.





Transformimi Digjital

Gjatë vitit 2025, digjitalizimi në kuadër të ShKÇAK ka mbetur një prioritet strategjik, me fokus në finalizimin e fazës 2 dhe fazës 3. Pas takimeve dhe testimeve të zhvilluara me palët relevante, këto faza janë pothuajse të përfunduara, duke shënuar progres të rëndësishëm në konsolidimin e platformës digjitale.

Gjatë vitit janë funksionalizuar modulet kryesore, përfshirë HR (Menaxhimi i Burimeve Njerëzore) dhe Menaxhimi/Mësimi Online, të gatshme për përdorim operacional. Ndërkohë, në fazën finale të implementimit mbeten disa komponentë shtesë, si Business Intelligence (BI) dhe aplikacioni mobil, i cili është në fazë përgatitore për lansim.

Sa i përket CMS-së dhe portalit të ShKÇAK-ut, është konstatuar se versioni aktual nuk i përgjigjet më plotësisht kërkesave të reja dhe nevojave për rrjedha pune më të avancuara; për këtë arsye është planifikuar zhvillimi i një versioni të ri (V. 2.0) me kërkesa funksionale dhe më fleksibile.

Fokusimi për vitin e ardhshëm do të jetë trajnimi i stafit administrativ dhe teknik për përdorimin efektiv të moduleve të implementuara, përmes sesioneve të strukturuar dhe mbështetjes praktike, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe sigurimin e një përdorimi të qëndrueshëm të sistemeve digjitale në operacionet e përditshme.



Për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Profesionit të Kontabilitetit, ShKÇAK organizoi Konferencën vjetore me temë “Epoka e Inteligjencës Artificiale: Teknologjia si mjet, vlerat si mision” duke mbledhur mbi 200 pjesëmarrës. Konferenca synoi të theksojë rëndësinë e balancës ndërmjet inovacionit teknologjik dhe misionit tonë profesional për integritet, etikë dhe përgjegjësi.



Në fjalimin e tij të mirëseardhjes, z. Adrian Alo, Kryetar i Bordit të ShKÇAK, theksoi “Ne në Shoqatë po i avancojmë programet tona për të siguruar që çdo anëtar të jetë i pajisur me kompetenca digjitale, njohuri mbi të dhënat dhe vetëdije etike të nevojshme për epokën e Inteligjencës Artificiale. Ne po krijojmë partneritete me organizata globale për të sjellë ekspertizë ndërkombëtare në Kosovë. Dhe po rrisim ndërgjegjësimin se inovacioni nuk është opcional, është thelbësor për të ardhmen tonë. Ju, anëtarët tanë, jeni zemra e këtij profesioni në Kosovë. Roli juaj është mjaft i rëndësishëm gjatë këtij ndryshimi i cili mund të jetë sfidues, por i domosdoshëm për të përmbushur kërkesat e kohës”

Në fjalimin e tij, z. Ahmet Ismaili, Guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, theksoi “Përdorimi i Inteligjencës Artificiale duhet të shoqërohet me qeverisje të fortë, kontrollë të përshtatshme dhe etikë profesionale. Për këtë, BQK ka avancuar kornizën rregullative përmes miratimit të Rregullores për Sistemet e Informacionit dhe Menaxhimin e Rrezikut Kibernetik dhe Strategjisë për Sigurinë Kibernetike, krahas forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse për të siguruar një përdorim të qëndrueshëm dhe të sigurt të teknologjive të avancuara, duke ruajtur stabilitetin financiar, besimin publik dhe integritetin e sistemit.”





Në fjalimin e saj, znj. Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës theksoi “Zhvillimi i Intelegjencës Artificiale po hap mundësi të reja për automatizimin e proceseve dhe rritjen e efikasitetit në punë. Por duhet cekur se, megjithë avancimet e saj, AI vështirë se mund të zëvendësojë gjykimin profesional, integritetin dhe përgjegjësinë që ne mbajmë si auditorë. Andaj, duhet shërbyer si mjet që mbështet dhe fuqizon profesionin tonë, duke mundësuar analizimin e më shumë të dhënave, identifikimin e parregullsive në kohë reale dhe ofrimin e vlerës së shtuar në proceset e auditimit. Pra, përmes përdorimit etik, transparent dhe të përgjegjshëm, AI mund të bëhet aleat i rëndësishëm në rritjen e cilësisë dhe ndikimit të auditimit publik.”

Në fjalimin e tij të mirësearchjes, z. Mentor Hyseni, Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës theksoi “Ne jemi brezi që do ta përkufizojë raportin ndërmjet njeriut dhe inteligjencës artificiale në profesionet financiare, por historia do të na gjykojë jo për mjetet që përdorim, por për vlerat që mbrojmë.”



Gjatë Konferencës anëtarët u përshëndetën dhe nga Drejtori Ekzekutiv i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve - z. Lee White.



Gjatë konferencës u zhvillua paneli i diskutimit profesional mbi rolin e teknologjisë dhe edukimit në transformimin e profesionit “Investimi në Teknologji dhe Edukimi i Profesionistëve drejt Epokës së Inteligjencës Artificiale”

Paneli u moderua nga z. Blerim Pushkolli, Ushtrues Detyre i Drejtorit Ekzekutiv të ShKÇAK, ndërsa panelistët ishin:

- z. Yll Dushi – Drejtor Ekzekutiv në OneFor
- znj. Valerina Gjoci – Anëtare e Bordit në ShKÇAK dhe Partnere e Auditimit në Grant Thornton Kosovo
- z. Xhavit Gashi – Shef i Zyrës për Zhvillim dhe Drejtor i Programit Paqe dhe Konflikt në RIT Kosovo
- znj. Zana Tabaku – Bashkë-themeluese dhe Drejtoreshë Ekzekutive në APPDEC
- znj. Edona Perjuci – Eksperte e Edukimit në ShKÇAK dhe Profesoreshë në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës



Konkluzionet kryesore:

- Investimi në teknologji në të gjitha sektorët, veçanërisht në sektorin financiar, është i domosdoshëm për të rritur konkurrueshmërinë ndërkombëtare dhe zhvillimin ekonomik të vendit.
- Edukimi dhe ngritja e aftësive digjitale të profesionistëve janë çelësi për të shfrytëzuar potencialin e Inteligjencës Artificiale, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet universiteteve dhe sektorit privat.
- Teknologjia është mjet, jo qëllim – profesionistët duhet të zhvillojnë etikën, gjykimin profesional dhe mendimin kritik, që përbëjnë vlerat themelore të profesionit.
- ShKÇAK do të ketë rol udhëheqës në këtë transformim përmes kualifikimeve bashkëkohore, programeve të edukimit të vazhdueshëm dhe përshtatjes së standardeve ndërkombëtare me epokën e AI-së.
- Inteligjenca Artificiale nuk duhet parë si kërcënim, por si mundësi për zhvillim profesional dhe inovacion.

Në kuadër të Konferencës u mbajtë dhe sesioni i Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP), me temën: “Etika profesionale në epokën e zhvillimeve digjitale”

Ligjërues: z. Hysen Çela – Ekspert i Etikës Profesionale, Profesor në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tiranës



ShKÇAK duke qenë anëtare në Odat Ekonomike të cilat veprojnë në Kosovë është zëri i anëtarëve të saj përmes pjesëmarrjes në cilësi të anëtarit të bordit apo anëtarë të komisioneve të ndryshme. Gjatë këtij viti Shoqata ka qenë mjaft aktive në lidhje me zhvillimet dhe të rejat e fundit, duke kontribuar me rekomandime për ndryshime në legjislacion, në avokimin e rëndësisë së raportimit financiar, avansimit të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit dhe çështje tjera me interes publik.

ShKÇAK në bashkëpunim me Odën Ekonomike e Kosovës dhe me mbështetjen e Bankës Botërore - Qendra për Reforma të Raportimit Financiar, organizuan trajnimin dy ditor me titull "Menaxhmenti Financiar për bizneset".

Ky trajnim kishte synim forcimin e kapaciteteve teknike për të mbështetur zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë.

Gjatë këtij trajnimi janë trajtuar temat më thelbësore të menaxhimit financiar, duke përfshirë:

- Planifikimin dhe kontrollin financiar;
- Menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Analizën financiare dhe interpretimin e raporteve;
- Marrjen e vendimeve investuese dhe financimin e biznesit;
- Menaxhimin e riskut financiar.

Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin përfaqësues të bizneseve anëtare të Odës Ekonomike të Kosovës. Trajnimi u mbajt nga ligjërues të ShKÇAK, të cilët ishin pjesë e programit të trajnimit të trajnerëve të zhvilluar nga Banka Botërore.



Përfaqësues të ShKÇAK morën pjesë në shënimin e 25-vjetorit të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), duke shprehur mbështetjen e saj për rolin dhe kontributin institucional të ATK-së në zhvillimin e sistemit tatimor dhe forcimin e transparencës financiare në vend.



SHKÇAK aktive në sferën rajonale dhe globale

SHKÇAK mban kontakte të vazhdueshme me të gjitha organizatat profesionale të rajonit.

SHKÇAK dhe Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë gjatë (IEKA) nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, që synon forcimin e standardeve profesionale dhe rritjen e bashkëpunimit në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.

Marrëveshja parasheh:

- Njohjen reciproke të certifikimeve profesionale
- Promovimin e zhvillimit profesional dhe edukimit të vazhdueshëm
- Përmirësimin e cilësisë së auditimit përmes shkëmbimit të praktikave dhe ekspertizës
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta profesionale
- Bashkëpunim për përkthimin dhe përditësimin e standardeve ndërkombëtare

Ky partneritet është një hap i madh drejt integritimit profesional rajonal dhe promovimit të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit.



Pjesëmarrja në Konferencën Rajonale “Power of Cooperation” (Fuqia e Bashkëpunimit) e organizuar nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm të Shqipërisë.

Pjesë e kësaj konference ishin edhe përfaqësues të SHKÇAK znj. Fitore Neziri, Nënkytare e Bordit dhe Znj. Ardiana Bunjaku, Këshilltare. Znj. Bunjaku ishte e ftuar si paneliste, ku ndau përvojën dhe vizionin e saj mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në zhvillimin e funksionit të auditimit në nivel rajonal. Në kuadër të panelit ajo theksoi nevojën për një qasje të koordinuar, profesionalizëm të lartë dhe ndarje të praktikave më të mira ndërmjet institucioneve të rajonit.

Kjo ngjarje mbledhi së bashku auditorë të brendshëm dhe të jashtëm nga sektori publik dhe privat në rajon, me qëllim fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, shkëmbimin e përvojave dhe adresimin e sfidave të përbashkëta në fushën e auditimit.



Pjesëmarrja në Simpoziumin e 10-të Ndërkombëtar të Kontabilistëve dhe Auditorëve, të organizuar nga Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar të Malit të Zi (ICAM) në bashkëpunim me Qendrën për Reformën e Raportimit Financiar të Bankës Botërore (CFRR).

Simpoziumi mbledhi profesionistë nga rajoni, BE dhe më gjerë për të diskutuar tema kyçe si:

- Raportimi për qëndrueshmëri dhe standardet e reja të BE-së;
- Roli i AI dhe dixhitalizimit në kontabilitet dhe auditim;
- Parandalimi i pastrimit të parave;
- Qeverisja korporative dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

SHKÇAK vazhdon të jetë pjesë aktive e zhvillimeve rajonale dhe ndërkombëtare të profesionit.



Pjesëmarrja në ceremoninë e 25-vjetorit të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar (IKM)

UD Drejtori Ekzekutiv z. Blerim Pushkolli i ShKÇAK mori pjesë në ceremoninë e shënimit të 25-vjetorit të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar-IKM ku ishte i ftuar si panelist në panelin me temë “Roli i profesionistit kontabël në një ekonomi të hapur”.

Gjatë panelit, ai theksoi rëndësinë e transparencës financiare, zbatimit të standardeve profesionale dhe rritjes së kapaciteteve të kontabilistëve si faktorë kyç për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe integrimin në tregjet ndërkombëtare.



Pjesëmarrja në Konferencën Ndërkombëtare të Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (EFAA)

Kryetari i Bordit të ShKÇAK, z. Adrian Alo përfaqësoi Shoqatën në Konferencën Ne EFAA, me temën: “Roli i Praktikave të Vogla dhe të Mesme (SMP) në fuqizimin e konkurrueshmërisë së sektorit privat dhe atij publik në Evropë.” Gjatë qëndrimit, ai mori pjesë gjithashtu në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore të EFAA-së, ngjarjet u zhvilluan në Marsejë, Francë.



Pjesëmarrja në Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë së Federatës së Kontabilistëve të Mesdheut (FCM)

Përfaqësuesit e ShKÇAK morën pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë së Federatës së Kontabilistëve të Mesdheut (FCM), e cila u mbajt në Ulqin, Mal të Zi. Në këtë takim Asambleja miratoi pasqyrat financiare për vitin 2024 dhe shënoi një moment të rëndësishëm me pranimin e anëtarit të ri – Institutit të Kontabilistëve të Maltës (MIA), duke forcuar më tej zërin e profesionit të kontabilitetit në rajonin e Mesdheut në nivel global.



Intervista nga Kryetari i ShKÇAK për “Zërat Mesdhetarë” të FCM

Gjatë vitit 2025 u publikua intervista e Krytarit z. Adrian Alo në uebfaqen e FCM. “Zërat Mesdhetarë” është një seri e re intervistash e iniciuar nga Federata e Kontabilistëve të Mesdheut (FCM), që synon të promovojë liderшипin dhe vizionin strategjik të organizatave anëtare, të ndajë perspektiva mbi sfidat aktuale dhe zhvillimet e ardhshme të profesionit të kontabilitetit në rajonin mesdhetar, si dhe të pasqyrojë diversitetin, pasurinë dhe dimensionin njerëzor të komunitetit të FCM.

Intervistën e Kryetarit të Shoqatës e gjeni në këtë [Link](#).

Interview series: Mediterranean Voices



MEDITERRANEAN VOICES

Dr. Adrian Alo
Chairman of the Board

SCAAK
Society of Certified Accountants and Auditors
KOSOVO

ShKÇAK anëtarësohet në CFE Tax Advisers Europe

ShKÇAK e përfaqësuar nga Kryetari i Shoqatës z. Adrian Alo dhe UD Drejtori Ekzekutiv z. Blerim Pushkolli, është bërë anëtare e CFE Tax Advisers Europe, organizatë profesionale me seli në Bruksel që përfaqëson këshilltarët tatimor në gjithë Evropën. E themeluar në vitin 1959, CFE Tax Advisers Europe bashkon 33 organizata kombëtare nga 2 shtete evropiane, duke përfaqësuar mbi 200,000 profesionistë të tatimeve dhe financave. Si një zë i përbashkët për profesionin në nivel kontinental, CFE ka për mision t'i shërbejë interesi publik duke promovuar standardet më të larta të ekspertizës dhe integritetit në fushën tatimore. Me këtë anëtarësim, ShKÇAK fuqizon rolin e saj në integrimin e komunitetit të profesionistëve të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë në rrjetin evropian të profesionistëve, duke sjellë përfitime të rëndësishme për anëtarët dhe partnerët tanë, ndër të cilat:

- Qasje e drejtpërdrejtë në zhvillimet më të fundit të politikave tatimore të Bashkimit Evropian.
- Zgjerim i rrjetit profesional me organizata dhe profesionistë nga mbi 30 shtete të Evropës.
- Zhvillim i vazhdueshëm profesional përmes publikimeve, konferencave dhe iniciativave trajnuese.
- Shkëmbim dhe adoptim i praktikave më të mira për ngritjen e cilësisë, forcimin e etikës dhe avancimin e ekspertizës në shërbimet tatimore.

Ky anëtarësim shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të pozitës së ShKÇAK në nivel evropian dhe rritjes së vlerës së shtuar për të gjithë anëtarët e saj.



Pjesëmarrja në Konferencën e Federatës Mesdhetare të Kontabilistëve (FCM)

UD Drejtori Ekzekutiv i ShKÇAK, z. Blerim Pushkolli, dhe anëtari i Komitetit Ekzekutiv të Federatës Mesdhetare të Kontabilistëve (FCM), z. Nazmi Pllana, morën pjesë në konferencën e organizuar nga FCM me temë: “Kontabilistë të gatshëm për të ardhmen: inovacioni, qëndrueshmëria dhe ndikimi rajonal” në Lisbonë, Portugali.

Konferenca mbledhi përfaqësues të organizatave profesionale nga rajoni mesdhetar për të diskutuar rolin kyç të kontabilistëve në avancimin e qëndrueshmërisë, ESG-së (mjedis, shoqëri dhe qeverisje) dhe mbrojtjen e interesit publik.

Në kuadër të konferencës, z. Nazmi Pllana moderoi panelin me temë “Ndërtimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi rajonal”, ku u trajtuan mënyrat konkrete për forcimin e kapaciteteve të organizatave profesionale, rritjen e cilësisë së edukimit të vazhdueshëm për kontabilistët, si dhe rëndësia e partneritetit ndërmjet vendeve të rajonit për shkëmbim përvojash dhe harmonizim praktikash.



Anëtari i ShKÇAK z. Nazmi Pllana, është zgjedhur Kryetar i Federatës Mesdhetare të Kontabilistëve (FCM)

Anëtari i ShKÇAK z. Nazmi Pllana, është zgjedhur Kryetar i Federatës Mesdhetare të Kontabilistëve (FCM) për mandatin e ardhshëm 2026/2027. Ky është një sukses i rëndësishëm për ShKÇAK, profesionin e kontabilitetit në Kosovë dhe përfaqësimin e vendit tonë në arenën ndërkombëtare.

FCM përfaqëson profesionin e kontabilitetit në zonën e Mesdheut. Anëtarësia e saj përbëhet nga 17 organizata profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve nga 14 vende mesdhetare: Shqipëria, Bullgaria, Qiproja, Franca, Greqia, Kosova, Malta, Mali i Zi, Maroko, Portugalia, Spanja, Tunizia, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar. Nëpërmjet këtij rrjeti, FCM promovon shkëmbimin profesional, harmonizimin e standardeve dhe fuqizimin e rolit të profesionit të kontabilitetit në zhvillimin ekonomik dhe qeverisjen e mirë.

Zgjedhja e z. Pllana në krye të FCM-së është një dëshmi e besimit dhe vlerësimit për angazhimin e tij profesional, kontributin shumëvjeçar në zhvillimin e profesionit dhe standardeve të raportimit financiar, si dhe për reputacionin që ShKÇAK dhe komuniteti i kontabilistëve në Kosovë kanë ndërtuar gjatë viteve. Kjo pozitë e re do të mundësojë një zë edhe më të fuqishëm të Kosovës në diskutimet rajonale dhe ndërkombëtare që lidhen me profesionin e kontabilitetit dhe auditimit.

ShKÇAK do të vazhdojë ta mbështesë fuqishëm z. Pllana në detyrën e tij të re, duke kontribuar në agjendën e përbashkët për rritjen e transparencës financiare, forcimin e profesionalizmit dhe promovimin e standardeve të larta etike në të gjitha vendet anëtare të FCM.



Pjesëmarrja në takimin e rregullt të PAODAG dhe Konferencën vjetore të ICAB

Znj. Ardiana Bunjaku anëtare e Grupit për Zhvillim dhe Këshillim të Organizatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit (PAODAG) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Auditimit (IFAC) mori pjesë në takimin e rregullt të PAODAG, ku u trajtua plani i punës 2026 dhe tema që lidhen me zhvillimin dhe fuqizimin e organizatave profesionale të kontabilitetit, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe përmirësimin e standardeve profesionale.

Znj. Bunjaku gjithashtu mori pjesë në Konferencën vjetore të Institutit të Kontabilistëve të Çertifikuar të Barbadosit (ICAB), ku u diskutuan praktikat më të mira, sfidat aktuale të profesionit dhe roli i këshillimit profesional në përmirësimin e qeverisjes dhe transparencës.

Në kuadër të ngjarjeve u zhvillua dhe një workshop i PAODAG, i fokusuar në shkëmbimin e përvojave dhe rekomandimeve konkrete për avancimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale.




ShKÇAK vazhdon të jetë pjesë në Programet e Qendrës për Reforma për Raportim Financiar të Bankës Botërore.

Si pjesë e QRRF-së të Bankës Botërore, përfaqësuesit e ShKÇAK së bashku me përfaqësues të KKRF, Thesarit të Republikës së Kosovës, BMP në vazhdimësi kanë qenë pjesë e seminareve dhe punëtorive të organizuara nga kjo qendër.

- Pjesëmarrja në Konferencën Ministrore të Qendrës për reforma të raportimit financiar në Vjenë dhe forumin për reformat në kontabilitet dhe auditim
- Përfaqësues të ShKÇAK morën pjesën në Takimin XII të përbashkët të komuniteteve të praktikës të edukimit dhe raportimit financiar të organizuar në kuadër të Programit për Kontabilitetin dhe Raportimin në Sektorin Publik nga Qendra për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR).
- Përfaqësues të ShKÇAK morën pjesë në punëtorinë “Adapting Accounting Frameworks for SMEs and the IFRS for SMEs Accounting Standard Update – Training of Trainers Workshop”



Struktura Organizative



STUDENTËT E VITIT 2025

ShKÇAK në vazhdimësi vlerëson përkushtimin që tregojnë anëtarët e Shoqatës gjatë ndjekjes së programeve certifikuese. Edhe për vitin 2025 janë ndarë çmimet për Studentët e vitit si mirënjohje për rezultatet e arritura nga këta studentë, por edhe si inkurajim për studentët e tjerë për të vazhduar me përkushtimin e tyre drejt përfitimit të thirrjeve profesionale që ata i aspirojnë.

- ALBAN HUMOLLI - **AUDITOR I ÇERTIFIKUAR**
- ERA KASTRATI - **KONTABILIST I ÇERTIFIKUAR**
- FESTË ZEQRIRI - **TEKNIK I KONTABILITETIT**
- SARANDË NEZIRI SIQANI - **AUDITOR I BRENDSHËM I CERTIFIKUAR**
- DILA HASANAJ - **EKSPERT I LICENCUAR I FORENZIKËS FINANCIARE**
- VULLNET SHABANI - **EKSPERT I LARTË TATIMOR**



Sarandë Neziri Siqani - Ceremonia e shpalljes së studentëve të vitit, gjatë festës së fundvitit.



RAPORTET E KOMISIONEVE

Komisionet e ShKÇAK janë shtylla të rëndësishme në qeverisjen e Shoqatës duke luajtur rol kyç në arritjen dhe zhvillimin e qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve të Shoqatës dhe përmbushjen e objektivave të Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të FNK.

Komisionet e Shoqatës i përcjellin zhvillimet në fushat përkatëse të profesionit në vend dhe në botë dhe angazhohen që objektivat dhe aktivitetet e Shoqatës t'i reflektojnë ato zhvillime në shërbim të interesit publik. Komisionet shërbejnë si urë lidhëse në mes të anëtarëve dhe akterëve relevantë të profesionit në krijimin e një mjedisi të avancuar të punës për kontabilistët dhe auditorët.

Në anën tjetër, Komisionet e ShKÇAK përkujdesen për ruajtjen e integritetit profesional të anëtarëve, respektimin e Kodit të Etikës nga ata dhe pajtueshmërinë e punës së tyre me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit, si dhe të edukimit.



Raport nga

Komisioni për Nominime



Të nderuar anëtarë,

Komisioni për Nominime, si organ i Shoqatës i zgjedhur nga anëtarësia, është i ngarkuar me një përgjegjësi me rëndësi të veçantë në kuadër të funksionimit institucional dhe qeverisjes së brendshme të Shoqatës. Në vazhdimësi me praktikën e viteve të mëparshme, edhe gjatë këtij viti Komisioni ka demonstruar një nivel të lartë të përkushtimit dhe profesionalizmit në ushtrimin e mandatit të tij, duke arritur të realizojë me sukses procesin e nominimit brenda kornizës kohore të përcaktuar dhe në përputhje të plotë me aktet normative të Shoqatës.

Gjatë periudhës raportuese është zhvilluar procesi i nominimit për përbërjen e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë. Ky proces është zhvilluar në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale, duke vepruar në përputhje të plotë me rregulloren e brendshme, aktet normative përkatëse dhe parimet e transparencës dhe barazisë dhe ka pasur për qëllim sigurimin e përfaqësimit të drejtë të anëtarësisë, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përzgjedhjen e individëve me përvojë profesionale, integritet dhe gatishmëri për të kontribuar në realizimin e objektivave dhe misionit të shoqatës. Në vazhdimësi të punës së Komisionit për Nominime, gjatë tremujorit të katërt të vitit raportues ka filluar procesi i nominimit për përbërjen e Bordit të Shoqatës, Komisionit për Nominime, si dhe për plotësimin e përbërjes së Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë me një anëtar. Ky proces është iniciuar dhe zhvilluar në përputhje me dispozitat statutore dhe aktet normative përkatëse të Shoqatës.

Aktivitetet që lidhen me këtë proces, në pjesën më të madhe, janë përfunduar brenda periudhës raportuese, duke përfshirë fazat përgatitore, shpalljen e ftesës për nominim, pranimin dhe shqyrtimin paraprak të nominimeve.

Faza përfundimtare e procesit, e cila përfshin finalizimin e procedurave dhe përgatitjen e rekomandimeve përkatëse, përkatësisht listës përfundimtare të anëtarëve për votim në Kuvendin e Anëtarëve, është planifikuar të zhvillohet në fillim të vitit 2026. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar inkurajimit të nominimit të sa më shumë anëtarëve, me qëllim të zgjerimit të bazës së pjesëmarrjes dhe rritjes së përfaqësimit gjithëpërfshirës brenda strukturave të shoqatës. Sa më i gjerë të jetë spektri i nominimeve aq më e madhe është mundësia për përzgjedhjen e përfaqësuesve kompetentë dhe për ndërtimin e organeve funksionale dhe efektive. Në këtë drejtim, gjatë këtij viti është evidentuar një rritje e ndjeshme e numrit të nominimeve krahasuar me periudhat paraprake, duke dëshmuar një nivel më të lartë të angazhimit dhe interesimit të anëtarësisë për pjesëmarrje aktive në jetën organizative të shoqatës.

Të gjitha nominimet janë shqyrtuar dhe vlerësuar në përputhje me kriteret e përcaktuara, duke u siguruar që kandidatët e nominuar të përmbushin kërkesat profesionale për ushtrimin e funksioneve përkatëse. Procesi është zhvilluar brenda afateve të parashikuara dhe në mënyrë të rregullt, pa u konstatuar parregullsi procedurale, duke garantuar integritetin dhe besueshmërinë e tij. Shoqata do të vazhdojë të promovojë dhe të inkurajojë në mënyrë aktive nominimin dhe përfshirjen e anëtarëve në organet e saj, me qëllim të forcimit të qeverisjes së brendshme, rritjes së efikasitetit institucional dhe sigurimit të një përfaqësimi të denjë, profesional dhe kredibil të shoqatës në raport me anëtarësinë, partnerët dhe institucionet relevante.

Adrian Alo

Kryesues i Komisionit për Nominime



Raport nga

Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë

Të nderuar anëtarë,

Përmes këtij raporti synojmë të prezantojmë punën e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë gjatë vitit 2025, duke pasqyruar përbushjen e detyrave dhe përgjegjësisë të tij në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e ShKÇAK, si dhe me legjislacionin në fuqi.

Gjatë këtij viti, Komisioni ka punuar me përkushtim në avancimin e funksionimit të tij, duke siguruar aprovimin e Bordit të Shoqatës për rishikimin dhe ridizajnimin e Rregullores së Komisionit, si dhe për hartimin e një draft-manuali për shqyrtimin e rasteve disiplinore.

Në bashkëpunim me Zyrën Ekzekutive, janë zhvilluar aktivitete të ndryshme për mbështetjen e anëtarëve të rinj, përmes përpilimit të rekomandimeve dhe udhëzimeve lidhur me etikën profesionale. Kjo qasje proaktive ka kontribuar në ngritjen e ndërgjegjësimit për standardet etike dhe profesionale, gjë që reflektohet edhe në faktin se gjatë vitit 2025 nuk është raportuar asnjë rast i shkeljes së Kodit Etik apo i legjislacionit në fuqi. Ky është një tregues pozitiv i zhvillimit profesional dhe etik të anëtarëve tanë.

Komisioni ka ndjekur një agjendë të orientuar drejt promovimit të Standardeve Profesionale dhe Kodit Etik, duke organizuar ligjërata dhe komunikime informuese për anëtarët lidhur me ndryshimet në standarde dhe në legjislacionin tatimor, si dhe për adresimin e sfidave që lidhen me ushtrimin e profesionit. Këto aktivitete kanë ndihmuar veçanërisht anëtarët e rinj që të kuptojnë më mirë detyrimet profesionale dhe etike që rrjedhin nga profesioni i tyre.

Si kryesues i Komisionit, vlerësoj se gjatë vitit 2025 kemi punuar me përkushtim për përfaqësimin, mbështetjen dhe fuqizimin e anëtarëve të ShKÇAK. Në vitin 2026, synojmë të intensifikojmë përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit rreth Kodit Etik dhe promovimin e rasteve nga praktika, me qëllim të forcimit të mëtejshëm të standardeve profesionale.

Po ashtu, do të zgjerojmë bashkëpunimin me institucionet relevante për të ngritur më tej vlerën dhe pozitën e profesionistëve të kontabilitetit dhe auditimit, duke mbështetur respektimin e ligjeve dhe standardeve profesionale. Urojmë që të gjithë anëtarët e ShKÇAK të vazhdojnë ta ushtrtojnë profesionin e tyre me integritet, përgjegjësi dhe përkushtim, duke respektuar Kodin Etik dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare.

Ylli Llonçari

Kryesues i Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë

Raport nga

Komisioni për Edukim dhe Standarde Profesionale



Të nderuar anëtarë,

Gjatë vitit 2025, Komisioni për Edukim dhe Standarde Profesionale ka vijuar angazhimin e tij në realizimin e objektivave strategjike të ShKÇAK, duke kontribuar në forcimin e kornizës së edukimit profesional dhe në avancimin e standardeve të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë. Aktivitetet e Komisionit janë zhvilluar në përputhje me strategjinë institucionale të Shoqatës dhe në harmoni me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Një komponent i rëndësishëm i veprimtarisë së Komisionit gjatë këtij viti ka qenë bashkëpunimi dhe pjesëmarrja aktive në iniciativa ndërkombëtare, veçanërisht përmes takimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta me Federatën Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për SME-të (EFAA). Ky bashkëpunim ka mundësuar shkëmbimin e përvojave profesionale, ndjekjen e zhvillimeve më të fundit në nivel evropian dhe përfaqësimin e interesave të profesionit në Kosovë në proceset konsultative dhe diskutimet relevante.

Shoqata ka bërë hap të rëndësishëm drejt avancimit të njohurive dhe ndërgjegjësimit profesional për qëndrueshmërinë, duke lansuar për herë të parë trajnimin inovativ “Bazat e ESG” – një program që shënon një bashkëpunim strategjik ndërmjet ShKÇAK dhe Institutit Amerikan të Auditorëve të Çertifikuar (AICPA) dhe CIMA. Ky trajnim përfaqëson hap të rëndësishëm në drejtim të edukimit profesional dhe ngritjes së kapaciteteve në fushën e raportimit të qëndrueshmërisë, në përputhje me zhvillimet dhe kërkesat ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Komisioni i Edukimit së bashku me Departamentin e Edukimit dhe Standardeve Profesionale ka analizuar materialet shtesë të AICPA me qëllim që të vazhdojë me ofrimin e trajnimeve më të avancuara.

jë kuadër të këtij angazhimi, janë realizuar disa takime online me përfaqësuesit e AICPA, për të koordinuar përmbajtjen dhe qasjen e programit të ri të certifikimit “ESG të avancuar” dhe planifikojmë të zhvillojmë modulën “Analizat e të të dhënave”Gjatë vitit 2025, Komisioni së bashku me EFAA ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në shqyrtimin dhe komentimin e projektstandardeve dhe dokumenteve konsultative, duke vlerësuar ndikimin e tyre potencial në praktikën profesionale dhe në kornizën rregullative vendore. Ky proces ka synuar të sigurojë që zbatimi i standardeve ndërkombëtare të jetë i përshtatshëm për kontekstin vendor dhe të mbështesë cilësinë dhe besueshmërinë e raportimit financiar.

Një fokus i veçantë i punës së Komisionit ka qenë azhurnimi i rregulloreve të edukimit, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit (IES) dhe me nevojat aktuale të tregut të punës. Këto ndryshime kanë për qëllim forcimin e përgatitjes profesionale të kandidatëve, rritjen e transparencës së procesit certifikues dhe ruajtjen e krahasueshmërisë ndërkombëtare të kualifikimeve të ofruara nga ShKÇAK.

Në vazhdimësi të aktiviteteve të përvitshme, Komisioni ka realizuar vlerësimin sistematik të ndryshimeve në standardet profesionale dhe të raportimit financiar, me synim përfshirjen e tyre në mënyrë të strukturuar dhe të përditësuar në materialet studimore dhe programet certifikuese.

Lulzim Zeka

Kryesues i Komisionit për Edukim dhe Standarde Profesionale



Raport nga Komisioni për Menaxhim të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standardet

Të nderuar anëtarë,

Viti 2025 ka qenë një vit i rëndësishëm për fuqizimin e menaxhimit të cilësisë dhe të pajtueshmërisë me standardet profesionale në fushën e raportimit financiar, kontabilitetit dhe auditimit. Përmes bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Komisionit për Menaxhimin e Cilësisë në Pajtueshmëri me Standardet (KMCPs) dhe Departamentit për Menaxhimin e Cilësisë në Pajtueshmëri me Standardet (DMCPs), është vazhduar me konsolidimin e proceseve të rishikimit dhe forcimin e besimit të publikut në shërbimet profesionale të anëtarëve të ShKÇAK. Gjatë këtij viti, një fokus i veçantë i është kushtuar raportimit vjetor të aktiviteteve përmes platformës elektronike të ShKÇAK. Raportimi për vitin 2024 u realizua gjatë vitit 2025, duke dëshmuar përmirësim të disiplinës profesionale dhe funksionalitet të procesit digjital. Në total, rreth 83% e thirrjeve profesionale raportuan me sukses. Kjo performancë reflekton një angazhim të mirë të anëtarëve dhe një administrim më efikas të procesit, duke u mbështetur edhe nga komunikimi i vazhdueshëm, rikujtimet dhe materialet udhëzuese që u ofruan nga DMCPs për anëtarët gjatë raportimit.

Raportimet e anëtarëve kanë dhënë edhe një pasqyrë të qartë mbi vëllimin e angazhimeve profesionale në vend. Gjatë vitit raportues, janë raportuar se anëtarët tanë kanë kryer mbi një mijë auditime ligjore, qindra auditime tjera dhe mbi një mijë rishikime, si dhe një numër i konsiderueshëm i pasqyrave financiare të përgatitura nga Kontabilistët/Auditorët e Certifikuar. Krahas kësaj, janë raportuar edhe tarifa relevante nga angazhimet profesionale, duke dëshmuar rolin ekonomik dhe profesional të shërbimeve të ofruara nga anëtarët tanë.

Në kuadër të menaxhimit të cilësisë, gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë veprime konkrete për avancimin e cikleve të rishikimeve.

Janë finalizuar raportet e menaxhimit të cilësisë për KC-të/AC-të e selektuara për kontroll nga cikli i kaluar. Janë pranuar komentet e anëtarëve, të cilët janë pajtuar me gjetjet dhe rekomandimet e dhëna. Raportet finale janë shqyrtuar dhe aprovuar nga KMCPs dhe u janë dërguar zyrtarisht anëtarëve. Po ashtu, gjatë vitit 2025 është iniciuar edhe procesi i kontrollit të dosjeve të auditimit të Auditorëve Ligjorë të selektuar nga cikli paraparak. Ky proces është zhvilluar sipas metodologjisë së përzgjedhjes dhe prioritizimit, me synim që raportet përkatëse të përgatiten dhe të finalizohen në ciklin pasues të raportimit. Në të njëjtën kohë, KMCPs ka vazhduar me aprovimin e mostrës së ShKÇAK anëtarëve për ciklin e rishikimeve të radhës, duke u bazuar në të dhënat e raportimit vjetor 2025 dhe në qasjen e bazuar në risk. Përzgjedhja dhe planifikimi i hapave të mëtejshëm janë trajtuar në kuadër të takimeve të komisionit gjatë vitit, me qëllim që procesi të mbetet i rregullt, i drejtë dhe i standardizuar.

Gjatë vitit 2025, Komisioni ka rekomanduar po ashtu tema për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional (EVP), të cilat lidhen me fushat ku janë vërejtur nevoja për përmirësim dhe ku ndryshimet në legjislacion dhe standarde kërkojnë azhurnim të vazhdueshëm profesional. Anëtarët janë njoftuar rregullisht për zhvillimet përkatëse dhe për kërkesat që rrjedhin nga standardet profesionale. KMCPs shpreh mirënjohje për bashkëpunimin e anëtarëve gjatë procesit të raportimit dhe rishikimeve të cilësisë. Qëllimi ynë mbetet i pandryshuar: të forcojmë pajtueshmërinë me standardet, të rrisim cilësinë e shërbimeve profesionale dhe të mbrojmë interesin publik.

Mentor Hyseni

Kryesues i Komisionit për Menaxhim të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standarde

Raport nga

Komisioni për Tatime



Të nderuar anëtarë,

Gjatë vitit 2025, Komisioni i Tatimeve ka vepruar në pajtim me Rregulloren e Komisionit për Tatime të aprovuar nga Bordi i SHKÇAK, me Planin e Punës, si dhe në përputhje me kërkesat e palëve të interesit.

Në fillim të vitit, Komisioni i Tatimeve ka dhënë propozimet e veta për planin e EVP-së për vitin 2025. Gjithashtu, Komisioni ka qenë i angazhuar në debate dhe aktivitete të organizuara me palë të treta lidhur me gjendjen e politikave dhe sistemit tatimor në vend. Në kuadër të këtyre angazhimeve, gjatë vitit 2025 janë realizuar disa takime dhe pjesëmarrje të rëndësishme institucionale.

Komisioni ka marrë pjesë në takime të organizuara nga Oda Gjermane e Tregtisë si anëtar i Klasterit për Tatime dhe Taksa, përfshirë takimet e zhvilluara në shkurt, maj, qershor dhe dhjetor, ku janë diskutuar çështje që lidhen me politikën fiskale, planin e punës afatmesëm, ndryshimet legjislative nga Ligji i ri për Administrimin e Procedurave Tatimore, si dhe pasojat juridike të disa dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore. Në këto takime janë trajtuar gjithashtu tema me interes për anëtarësinë, si zgjerimi i shërbimeve elektronike në platformën "EDI" dhe rregullimi i humbjeve në peshë specifike ose substancë, dëmtimeve, mbetjeve dhe shkatërrimeve apo thyerjeve gjatë procesit të prodhimit dhe transportit.

Po ashtu, Komisioni ka marrë pjesë në Forumin e organizuar nga Oda Amerikane e Tregtisë në bashkëpunim me ATK, ku janë diskutuar çështje që lidhen me administrimin aktual të Ligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore. Gjithashtu, është realizuar pjesëmarrje në takime të organizuara nga ATK me partnerë institucionalë lidhur me zbatimin e ligjeve dhe politikave operative të ATK-së në raport me tatimpaguesit.

Një zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit 2025 ka qenë anëtarësimi i SHKÇAK në organizatën ndërkombëtare CFE Tax Advisers Europe, me qëllim krijimin e një ure lidhëse ndërmjet ekspertëve tatimorë në vendin tonë dhe ekspertëve tatimorë të vendeve të Bashkimit Evropian.

Pjesëmarrja në takimet e Odës Ekonomike Amerikane dhe në panelet e ndryshme është shoqëruar vazhdimisht me komente dhe propozime konkrete për ndryshime tatimore. Komisioni ka qenë aktiv edhe në grupet punuese të NJIF gjatë disa takimeve të mbajtura gjatë vitit 2025, si dhe ka marrë pjesë gjatë muajit shkurt në një takim në Sekretariatën e Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, lidhur me Dialogun Publiko-Privat. Në takimet me Drejtorin e Përgjithshëm të ATK-së është premtuar se zotimi për mundësinë e gjenerimit të gjendjes së përgjithshme të tatimpaguesit do të zbatohet në një periudhë të shpejtë.

Në vitin e ardhshëm, Komisioni i Tatimeve pret nga institucionet vendimmarrëse, përkatësisht MFPT dhe Administrata Tatimore e Kosovës, që anëtarëve të SHKÇAK, e sidomos Komisionit të Tatimeve, t'u mundësohet një përfshirje dhe rol më domethënës në hartimin e politikave fiskale, me qëllim të mbrojtjes së interesit publik dhe interesit ekonomik të komunitetit biznesor, përmes lehtësimit të procedurave tatimore dhe atyre administrative për bizneset.

Fahri Breznica


Kryesues i Komisionit për Tatime

STATISTIKA

Shërbimet që ofrohen nga anëtarët e ShKÇAK

Në grafikun në vijim është paraqitur shpërndarja e shërbimeve nga anëtarët tanë nëpër sektorë të ndryshëm, duke u dalluar shërbimet e auditimit, shërbimet kontabël, këshillimet për tatime, mbajtja e librave kontabël dhe të tjera të ngjashme të përfaqësuar në një gamë të gjerë të sektorëve të punës. Prandaj, ngritja e kapaciteteve në këtë profesion është e domosdoshme në mënyrë që profesionistët të mbulojnë tërë sektorin privat dhe publik.


Shërbimet që ofrohen nga anëtarët e ShKÇAK



Anëtarët Aktiv ndër vite

Statistikat e ShKÇAK flasin për një rritje të theksuar të numrit të anëtarëve aktiv nga viti 2022-2025. Kjo rritje atribuohet në përgjithësi në rritjen e ndërgjegjësimit dhe nevojës për profesionalizëm në fushën e kontabilitetit dhe auditimit si dhe në mbështetjen që ShKÇAK ju ofron anëtarëve të saj.

Anëtarët aktiv të ndër vite




Studentët e regjistruar gjatë vitit 2025

Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e studentëve të ri të cilët janë regjistruar në programet çertifikuese të ShKÇAK.

Gjatë vitit 2025 janë regjistruar në nivelin para kualifikues Teknik i Kontabilitetit 199 studentë. Specifikisht, 83 studentë janë regjistruar në programin për nivelin kualifikues “Kontabilist i Çertifikuar”, 42 studentë janë regjistruar në programin për të marrë titullin “Auditor i Çertifikuar”, në nivelin Auditor i Brendshëm i Çertifikuar janë regjistruar 16 studentë.

Numri i studentëve të rinjë sipas programeve çertifikuese




Programi Auditor i Brendshëm i Çertifikuar

Programi specializues për Auditim të Brendshëm ka filluar në vitin 2017 si një specializim i ri shumë nevojshëm dhe i dobishëm si për sektorin privat ashtu dhe për sektorin publik.

Sipas grafikut të mëposhtëm për periudhën 2017-2025 janë regjistruar 269 studentë nga të cilët 151 prej tyre kanë fituar thirrjen Auditor i Brendshëm i Çertifikuar, të cilët profesionalisht janë të gatshëm të ofrojnë ekspertizën e tyre në fushën e Auditimit të Brendshëm në sektorin privat dhe publik.

Auditor i Brendshëm i Çertifikuar




Pjesëmarrja në profesion sipas gjinisë

Tradicionalisht, profesioni i kontabilitetit dhe auditimit ka qenë i përfaqësuar më shumë nga gjinia mashkullore jo vetëm në vendin tonë por edhe në botë. Megjithatë, në kohët e fundit ka pasur një ndryshim pozitiv në këtë drejtim, duke u ngritur gradualisht numri i ushtruesëve të këtij profesioni nga gjinia femrore.

Grafiku i mëposhtëm tregon se gjatë vitit 2025, përqindja e anëtarëve femra te Shoqatës ka qenë 55.52%, ndërsa e anëtarëve meshkuj ka qenë 44.48%. Kështu, krahasuar me vitin 2002 ku pjesëmarrja e femrave si anëtarë të shoqatës ka qenë vetëm 14%, viti 2025 vazhdon të mbajë pjesëmarrjen e femrave në epërsi.

Anëtarët aktiv të shoqatës sipas gjinisë



PASQYRAT FINANCIARE



**Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar
dhe Auditorëve të Kosovës**

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve
të pavarur**
Për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2025

Përmbajtja:

| | |
|--|---|
| Raporti i auditorëve të pavarur----- | 3 |
| Pasqyra e pozitës financiare ----- | 5 |
| Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse ----- | 6 |
| Pasqyra e ndryshimeve në fonde ----- | 7 |
| Pasqyra e rrjedhës së parasë----- | 8 |
| Shënimet e pasqyrave financiare----- | 9 |

Raport i Auditorit të Pavarur

Drejtuar: Kuvendit të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **Shoqatës së kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës**, të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2025, si dhe Pasqyrën e të Ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në fonde për vitin e mbyllur në këtë datë, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të **Shoqatës së kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës** më 31 Dhjetor 2025, performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Raportim Financiar për NVM.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë trajtuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tone më sipër, dhe ne nuk do të japin një opinion të veçantë mbi këto çështje.

| Çështje tjera | Si i adresoj auditimi ynë çështjet tjera |
|--|--|
| Njohja e të ardhurave nga trajnimet, provimet dhe antarësia | Procedurat tona të auditimit përfshinë: |
| Njohja e të ardhurave nga shërbimet e trajnimit, tarifat e provimeve dhe abonimet e anëtarësisë është ka qen një fushë e rëndësishme e auditimit për shkak të kompleksitetit të detyrimeve të performancës, kohës së njohjes së të ardhurave dhe përputhshmërisë me standardet nderkombetare te raportimit financiar per NVM. Ekziston rreziku që të ardhurat nga këto burime të njihen para kohe ose të alokohen gabimisht në periudha raportimi, veçanërisht në rastet që përfshijnë shërbime të bashkuara ose të ardhura | Vlerësimin e politikave të njohjes së të ardhurave të kompanisë për përputhshmëri me SNRF per NVM. Shqyrtimin e kohës së njohjes së të ardhurave për shërbimet e trajnimit (të njohura gjatë periudhës së shërbimit), tarifat e provimeve (të njohura pas përfundimit të tyre) dhe abonimet e anëtarësisë (të njohura gjatë periudhës së abonimit). Testimin e një mostre të transaksioneve për të verifikuar që të ardhurat janë regjistruar në |

| | |
|---|---|
| <p>të shtyra.</p> <p>Detajet për politikat e kontabilitetit janë të shpalosura ne Shënimin 2.7 të pasqyrave financiare.</p> | <p>periudhën e saktë dhe në përputhje me kushtet kontraktuale.</p> <p>Shqyrtimin e bilanceve të të ardhurave të shtyra dhe amortizimit të tyre për të siguruar alokim të duhur gjatë kohës.</p> <p>Vlerësimin e mjaftueshmërisë së shpalosjeve në pasqyrat financiare në lidhje me politikat e njohjes së të ardhurave dhe gjykimet kyçe të zbatuara.</p> |
|---|---|

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me Qeverisjen e Pasqyrave Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për NVM dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likujdijë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë. Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.

- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmentit, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.



Ymer Shatri – Auditor Ligjor
Audit and Conto
Prishtinë, Kosovë
26 Shkurt 2026



PASQYRA E POZITËS FINANCIARE**Me 31 dhjetor 2025***Të gjitha shumat në Euro*

| | Shpalosjet | 31.12.2025 | 31.12.2024 (e riparaqitur) | 01.01.2024 (e riparaqitur) |
|---|------------|----------------|-------------------------------|-------------------------------|
| PASURITE | | | | |
| Pasurite jo-qarkulluese | | | | |
| Prona, impiantet dhe pajisjet | 3 | 24,720 | 21,481 | 27,478 |
| Hapsirat e reja | 3 | 89,467 | 1,718 | |
| Investimet kapitale | | 125,817 | 81,030 | 71,093 |
| | | 240,004 | 104,229 | 98,571 |
| Pasurite qarkulluese | | | | |
| Stoqet - librat | | 2,313 | 2,857 | 4,594 |
| Të arkëtueshmet dhe të arkëtueshmet tjera | 4 | 13,160 | 11,575 | 28,733 |
| Paraja dhe ekuivalentet e parasë | 5 | 605,453 | 664,546 | 613,848 |
| | | 620,926 | 678,978 | 647,175 |
| TOTAL PASURITË | | 860,931 | 783,207 | 745,745 |
| FONDET DHE DETYRIMET | | | | |
| Fondet | | | | |
| Teprica e akumuluar e te hyrave | | 712,760 | 661,206 | 614,875 |
| Fondi i përgjithshëm | | 712,760 | 661,206 | 614,875 |
| DETYRIMET | | | | |
| Detyrimet afat-shkurta | | | | |
| Detyrimet ndaj investimit | | 44,787 | | |
| Llogari të pagueshme dhe detyrime tjera | 6 | 18,888 | 20,570 | 20,847 |
| Të hyrat e shtyra | 7 | 84,496 | 101,432 | 110,023 |
| | | 148,171 | 122,001 | 130,870 |
| GJITHSEJ DETYRIMET | | 148,171 | 122,001 | 130,870 |
| GJITHSE FONDI DHE DETYRIMET | | 860,931 | 783,207 | 745,745 |


Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i ShKÇAK më 26 Shkurt 2026 dhe janë nënshkruar nga:

Teuta Ukshini

Drejtor Ekzekutiv


**Adrian Alo**

Kryetar i Bordit



PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025
Të gjitha shumat në Euro

| | Shpalosjet | 2025 | 2024 (e riparaqitur) |
|-----------------------------------|------------|------------------|-------------------------|
| Të hyrat operative | | | |
| Të hyrat nga edukimi | 8 | 418,116 | 349,984 |
| Të hyrat nga anëtarimi | 8 | 125,444 | 122,390 |
| Të hyrat nga menaxhimi i cilësisë | 8 | 63,800 | 60,800 |
| Të hyrat nga Dep Konsulences | 8 | 6,735 | 14,606 |
| Të hyra tjera | 8 | 22,426 | 22,731 |
| Totali i të hyrave | | 636,521 | 570,511 |
| Shpenzimet | | | |
| Shpenzimet e administratës | 9 | (212,075) | (204,686) |
| Shpenzimet e zhvlerësimit | 3 | (23,036) | (7,244) |
| Shpenzimet e trajnimit | 10 | (149,993) | (118,867) |
| Shpenzimet e provimeve | 11 | (17,928) | (17,014) |
| Sherbimi për anetarë | 12 | (152,797) | (152,447) |
| Shpenzimet e Dep Konsulencës | 13 | (29,137) | (23,922) |
| Totali i shpenzimeve | | (584,966) | (524,180) |
| Teprica e te hyrave | | 51,554 | 46,331 |

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE FONDE
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025
Të gjitha shumat në Euro

| | Me 31 dhjetor 2025 | Me 31 dhjetor 2024 (e riparaqitur) | Me 1 janar 2024 (e riparaqitur) |
|-----------------------------------|--------------------|---------------------------------------|------------------------------------|
| Me 01 janar | 661,204 | 614,857 | 558,167 |
| Ndryshime ne tepricen e akumuluar | | | 56,708 |
| Teprica e te hyrave per vitin | 51,554 | 46,331 | |
| | 712,760 | 661,206 | 614,857 |

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025
Të gjitha shumat në Euro

| | Shenim | 2025 Euro | 2024 (e riparaqitur) Euro |
|--|--------|------------------|------------------------------|
| AKTIVITETET OPERATIVE | | | |
| Teprica e te hyrave te vitit | | 51,554 | 46,331 |
| Zhvleresimi dhe amortizimi | 3 | 23,036 | 7,245 |
| Te arketueshmet dhe te arketueshmet tjera | | (1,585) | 17,157 |
| Stoqet | | 543 | 1,737 |
| Te pagueshmet tregtare dhe te tjera | | 43,106 | (278) |
| Te hyrat e shtyra | | (16,936) | (8,592) |
| Paraja neto nga aktivitetet operative | | 99,719 | 63,601 |
| AKTIVITETET INVESTUESE | | | |
| Blerja e prones, impianteve dhe pajisjeve | | (10,487) | (2,965) |
| Blerja e pasurise se paprekshme | | (148,325) | (9,937) |
| Net cash used in investing activities | | (158,812) | (12,902) |
| AKTIVITETET FINANCUESE | | | |
| Lëvizjet në aktivitetet financuese | | - | - |
| Paraja neto nga aktivite financuese | | - | - |
| rrjedha neto e parase per periudhen | | (59,093) | 50,698 |
| Paraja dhe ekuivalentet e parase ne fillim | | 664,546 | 613,848 |
| Paraja dhe ekuivalentet e parase ne fund | 5 | 605,453 | 664,547 |

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

1. Të përgjithshme

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (“SHKÇAK” ose “Organizata”) është organizatë jo profitabile e themeluar në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/22 dhe Ligji Nr.06/L- 043 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare. SHKÇAK është themeluar për qëllim të:

- Profesionalizmit të Ndërsjellë: për të përkrahur, mbrojtur dhe avancuar karakterin, statusin dhe interesat e profesionit të kontabilitetit në përgjithësi dhe të kontabilistëve e auditorëve në veçanti që janë anëtarë të SHKÇAK;
- Rritjes Profesionale: që të lehtësojë mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kompetencave të anëtarëve përgjatë karrierës së tyre;
- Integritetit: për të mbajtur nivelin më të lartë të standardeve profesionale dhe integritetit të anëtarëve në interes të komunitetit; dhe
- Përfaqësimit: për të përfaqësuar profesionin në komunitet.

Me 31 dhjetor 2025 dhe 2024, Organizata ka kryer aktivitetet me 14 dhe 12 të punësuar përkatësisht.

2 Politikat e kontabilitetit

Në vazhdim janë paraqitur politikat kryesore të kontabilitetit që janë adoptuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Pasqyrat Financiare janë përgatitur për vitet e përfunduara me 31 dhjetor 2025 dhe 2024. Të dhënat aktuale dhe karahasuese në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Euro, përderisa nuk ceket ndryshe. Kur është e nevojshme zërat krahasues janë harmonizuar konform ndryshimeve të vitit në prezantim.

2.2 Valuta funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro, e cila është valuta funksionale e organizatës.

2.4 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë balancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

2.5 Shkëmbimet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje.

2.6 Kundërbalancimi (offsetting)

Pasuritë financiare dhe detyrimet janë kundërbalancuar dhe raportuar në bilancin e gjendjes atëherë kur ka të drejtë të imponueshme ligjore për të kundërbalancuar shumat e njohura dhe ka synim të vendoset në baza neto, ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

2.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë njohur atëherë kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në Organizatë dhe këto benefite të mund të maten besueshëm.

Organizata njih të ardhurat duke i ngarkuar llojet në vazhdim:

- Tarifat e anëtarisë dhe tarifat e edukimit janë njohur fillimisht kur është lëshuar fatura. Të hyrat janë rregulluar në fund të vitit për të reflektuar vetëm të hyrat e fituara gjatë vitit.
- Të hyrat nga tarifat e edukimit dhe anëtarimit janë shtyrë për pagesat e pranura për paradhënie.

2.8 Prona, impiantet dhe paisjet

Prona, impiantet dhe paisjet janë bartur në kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar. Kostoja historike përfshin të gjitha shpenzimet direkt të atribueshme në përvetësimin e zëri.

Zhvlerësimi është ngarkuar duke përdorur metodën lineare në normat e paracaktuara në mënyrë që të alokohet kostoja e pronës, impianteve dhe paisjeve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

Në vazhdim është paraqitur jeta e përafërt e përdorimit e aplikuar ndaj zërave të rëndësishëm të pronës, impianteve dhe paisjeve:

2.9 Prona, impiantet dhe paisjet (vazhdim)

| | 2025 | 2024 |
|------------------------------|----------|----------|
| Mobiljet dhe paisjet | 2-5 vite | 2-5 vite |
| Paisjet e TI nën 1,000 Euro | 3 vite | 3 vite |
| Veturat | 5 vite | 5 vite |
| Investimet ne hapsira (zyra) | 5 vite | |

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të pasurive ose janë njohur si pasuri të ndara, si ka qenë e përshtatshme, vetëm kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në Organizatë dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur. Fitimet dhe humbjet mbi heqjet janë përcaktuar duke krahasuar shumatat me vlerat bartëse. Këto janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave.

2.10 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetëgjatësi të caktuar të cilat janë blerë veç e veç mbahen me kosto minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet në baza të njëjta përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurisë.

Pasuritë e pa prekshme të Organizatës përmbajnë Softuerë kompjuterik (investimi në digjitalizimin e procese), të drejtat autoriale për shfrytëzimin e librave dhe licence nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Gjithashtu këto pasuri përfshijnë koston e përkthimit të librave të programit të auditimit të brendshëm e cila është kapitalizuar si kosto e zhvillimit në pajtueshmëri me SNK 38 Pasuritë e paprekshme. Amortizimi ngarkohet duke përdorur metodën drejtvizore brenda pesë viteve përgjatë jetës së tyre të përdorimit pas kompletimit.

2.11 Dëmtimi i pasurive të prekshme dhe të paprekshme

Në fund të secilës periudhë raportuese, Organizata rishikon shumatat bartëse të pasurive të prekshme dhe të pa prekshme të saj për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dëshmi që ato pasuri kanë humbje nga dëmtimi.

Nëse ekziston ndonjë informacion i tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet në mënyrë që të përcaktohet masa e humbjeve nga dëmtimi (nëse ka).

Shuma e rikuperueshme është më e lartë se sa vlera e drejtë minus shpenzimet e hudhjes dhe vlera në përdorim. Në vlerësimin e vlerës së përdorimit, rrjedhat e ardhshme të parasë së gatshme janë të skontuara në vlerën e tyre të tanishme duke përdorur normën e skontimit të para-tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe riskun specifik të pasurisë për të cilën vlerësimet e rrjedheve të ardhshme të parasë nuk kanë qenë të rregulluara.

Nëse shuma e rikuperueshme e një pasurie vlerësohet të jetë më e vogël se vlera bartëse e saj, vlera bartëse e pasurisë zvogëlohet në shumën e rikuperueshme të saj. Një humbje nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim apo humbje, përveç rastit kur pasuria përkatëse mbahet me shumën e rivlerësuar, në këtë rast humbja nga dëmtimi trajtohet si rënje e rivlerësimit. Pasuritë që janë subjekt i amortizimit janë rishikuar për dëmtim kurdo që ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera bartëse mund të mos rikuperohet. Vlera bartëse e një pasurie është shënuar menjëherë në vlerë të rikuperueshme nëse vlera bartëse e një pasurie është më e lartë se vlera e rikuperueshme që është vlerësuar të jetë. Vlera e rikuperueshme është më e larta e vlerës reale të pasurisë minus kosto e shitjes dhe vlerës në përdorim.

2.12 Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Organizata i njeh si shpenzime kostot përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompensim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Organizata duhet të i përfitoj, konstruktoj apo të i njeh pasuritë jo-qarkulluese si të hyra të shtyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

2.13 Lizingu

Lizingu klasifikohet si lizing financiar sa herë që transferohen në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë të dhënë me qira ndaj Kompanisë. Të gjitha kontratat e tjera janë klasifikuar si lizing operativ.

Të drejtat për pasuritë e mbajtura si lizing financiar njihen si pasuri të Organizatës në vlerën e drejtë të pronës së dhënë me lizing (ose, në qoftë se vlera është më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të lizingut) në fillimin e lizingut. Detyrimi që korrespondon me qiradhënësin është përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar si një detyrim i lizingut financiar. Pagesat e lizingut ndahen mes të pjesës financiare dhe uljes së detyrimit të lizingut në mënyrë që të arrihet një normë konstante e interesit në bilancin e mbetur të detyrimit. Shpenzimet financiare zbriten gjatë kalkulimit të fitimit ose humbjes. Pasuritë e mbajtura me lizing financiar janë të përfshira në kuadër të zërit prona, pajisjet dhe impiantet, të cilat zhvlerësohen dhe vlerësohen për dëmtim (humbje nga rënia në vlerë) në të njëjtën mënyrë si pasuritë e tjera në pronësi.

Lizingu i pagueshëm operativ ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave në baza lineare përgjatë afatit të kontratës së lizingut.

2.14 Stoqet

Stoqet janë prezantuar me vlerën më të ulët ndërmjet kostos dhe çmimit të shitjes minus kostot e kompletimit dhe shitjes.

2.15 Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera

Shumica e shitjeve janë bërë në bazë të afateve normale të kreditimit, si dhe llogaritë e arkëtueshme nuk bartin interes. Ku kreditimi është zgjatur përtej afateve normale të kreditimit, llogaritë e arkëtueshme maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të arëktueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Në fund të çdo periudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera shqyrtohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që shumat nuk janë të rikuperueshme. Nëse është kështu, një humbje nga dëmtimi (rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

2.16 Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

2.17 Kreditë bankare dhe mbitërheqjet

Shpenzimet e interesit regjistrohen në bazë të metodës së interesit efektiv dhe janë përfshirë në shpenzimet financiare.

2.18 Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur kur kanë ndodhur.

2.19 Benefitet e të punësuarve

Organizata kontribon në planet pas pensionale të të punësuarve të saj siç përshkruhen nga legjislacioni i sigurimit i miratuar nga ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Kontributet, e bazuara në paga, u janë bërë organizatës nacionale që janë përgjegjëse për pagesën e pensioneve. Nuk ka detyrim shtesë në lidhje me këto plane dhe kështu këto skema janë konsideruar si plane të definuara të kontributeve. Organizata nuk ka benefite pas pensionale ndaj të punësuarve të saj.

2.20 Tatimi në fitim

SHKÇAK është krijuar si organizatë jo profitabile dhe prandaj, është e liruar nga tatimi në të ardhura të korporatave. SHKÇAK gjatë vitit 2025 nuk ka gjeneruar të hyra tjera nga aktivitetet ekonomike të cilat i nënshtrohen tatimit në të ardhura të korporatave.

Organizata nuk ka njohur ndonjë detyrim apo pasuri të shtyrë tatimore me 31 Dhjetor 2025, siç nuk ka ndryshime të përkohshme ekzistuese në ato data.

2.21 Gjykimet kritike dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Në zbatimin e politikave të kontabilitetit të SHKÇAK, të cilat janë përshkruar në shënimin 2 të këtyre pasqyrave financiare nga menaxhmenti kërkohet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime mbi vlerat bartëse të pasurive dhe detyrimeve që nuk janë lehtë të identifikueshme nga burimet tjera.

2.22 Korrigjimi i gabimit të periudhës së kaluar dhe riparaqitja retrospektive (IAS 8)

Në përputhje me IAS 8, Shoqëria ka korrigjuar gabimin në mënyrë retrospektive për periudhën 2024, duke riparaqitur shifrat krahasuese për vitin 2024 dhe duke riparaqitur bilancin hapës të periudhës më të hershme të paraqitur (01.01.2024 / 31.12.2023). Rregullimet përfshijnë:

- Njohjen e investimit në vijim – Granti i perfituar nga EBRD në vlerë prej 30,000 Euro në fund të vitit 2023 për projektin e digjitalizimit. Ky donacion është paguar direkt nga EBRD tek kompania kontraktuese për projektin e digjitalizimit dhe përfitues është SCAA.

- Zvogëlimi i investimeve në vijim për projektin e digjitalizimit në vlerë prej 6,748 Euro dhe është njohur si shpenzimi operativ i periudhës raportuese 2024.

- Njohja për të hyrat e shtyera të periudhës 2019-2020 më 01.01.2024 në vlerë prej 56,707 Euro dhe të periudhës 2021 më 31.12.2024 në vlerë prej 8,061 Euro të cilat e kanë plotësuar kushtin e njohjes sipas Rregullores financiare.

Tabela A — Efekti në bilancin hapës (01.01.2024 / 31.12.2023)

| Zëri | Siç ishte raportuar | Korrigjimi | I riparaqitur |
|------------------------------|---------------------|------------|---------------|
| Investimi / aktivi afatgjatë | 41,093 | 30,000 | 71,093 |
| Të hyra të shtyera (detyrim) | 136,731 | (26,708) | 110,023 |
| Fitime të mbajtura | 558,176 | 56,707 | 614,883 |

Tabela B — Efekti në Bilanc më 31.12.2024 (krahasues i riparaqitur)

| Zëri | Siç ishte raportuar | Korrigjimi | I riparaqitur |
|-------------------------------------|---------------------|------------|---------------|
| Investimi / aktivi (bruto ose neto) | 57,854 | 23,176 | 81,030 |
| Të hyra të shtyera | 136,240 | (34,808) | 101,432 |
| Fitime të mbajtura | 603,221 | 57,985 | 661,206 |

Tabela C — Efekti në P/L për vitin 2024 (krahasues i riparaqitur)

| Zëri | Siç ishte raportuar | Korrigjimi | I riparaqitur |
|---|---------------------|------------|---------------|
| Të hyrat | 562,451 | 8,061 | 570,511 |
| — prej të cilave: njohje nga të hyrat e shtyera | | 8,061 | |
| Shpenzimet operative | 517,396 | 6,784 | 524,180 |
| Fitimi neto i vitit | 45,054 | 1,277 | 46,331 |

3 Prona, impiantet dhe paisjet

| | Kompjuteret dhe paisjet tjera | Automjeti | Investimet në vijim - Zyre | Investimet në vijim - projekti për digjitalizim | Total |
|---|-------------------------------|-----------------|----------------------------|---|------------------|
| | Euro | Euro | Euro | Euro | Euro |
| Kosto | | | | | |
| Me 01 janar 2024 | 95,283 | 29,700 | | 41,093 | 166,076 |
| Korrigjimi i gabimit | | | | 30,000 | 196,076 |
| Me 01 janar 2024 e riparaqitur | 95,283 | 29,700 | | 71,093 | 196,076 |
| Shtesat gjatë vitit | 1,247 | - | 1,718 | 9,937 | 12,902 |
| Heqjet gjatë vitit | - | - | | | - |
| Me 31 dhjetor 2024 e riparaqitur | 96,530 | 29,700 | 1,718 | 81,030 | 208,978 |
| Me 01 janar 2025 | 96,530 | 29,700 | 1,718 | 81,030 | 208,978 |
| Shtesat gjatë vitit | 10,487 | - | 103,537 | 44,787 | 158,811 |
| Heqjet gjatë vitit | - | - | | | - |
| Më 31 dhjetor 2025 | 107,018 | 29,700 | 105,255 | 125,817 | 367,789 |
| Zhvleresimi i akumuluar | | | | | |
| Me 01 janar 2024 | (79,685) | (17,820) | - | | (97,505) |
| Zhvleresimi i vitit | (4,274) | (2,970) | - | | (7,244) |
| Zhvleresimi per heqjet gjate vitit | - | - | - | | - |
| Me 31 dhjetor 2024 | (83,959) | (20,790) | - | | (104,749) |
| Me 01 janar 2025 | (83,959) | (20,790) | - | | (104,749) |
| Zhvleresimi I vitit | (4,278) | (2,970) | (15,788) | | (23,036) |
| Zhvleresimi per heqjet gjate vitit | - | - | - | | - |
| Me 31 dhjetor 2025 | (88,237) | (23,760) | (15,788) | | (127,785) |
| Vlera neto ne libra | | | | | |
| Me 31 dhjetor 2024 | 12,571 | 8,910 | 1,718 | 81,030 | 104,229 |
| Me 31 dhjetor 2025 | 18,780 | 5,940 | 89,467 | 125,817 | 240,005 |

4 Llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshmet tjera

| | 2025 | 2024 (e riparaqitur) |
|--|---------------|----------------------|
| <i>Te arkëtueshmet</i> | | |
| Te arkëtueshmet nga anetaret | 6064 | 9,057 |
| Minus: Lejimi per borxhet e dyshimta nga anetaret | (607) | (702) |
| Gjithsej | 5,457 | 8,355 |
| <i>Te arkëtueshmet tjera</i> | | |
| Te arkëtueshmet tjera | 2,874 | |
| Interesi i arkëtueshem | 4,829 | 3,220 |
| | 7,703 | 3,220 |
| Total te arkëtueshmet dhe te arkëtueshmet tjera | 13,160 | 11,575 |

5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

| | 2025 | 2024 (e riparaqitur) |
|---------------------------------------|----------------|----------------------|
| Paraja në bankë | 185,453 | 244,546 |
| Depozitat afatshkurtëra të afatizuara | 420,000 | 420,000 |
| Gjithsej | 605,453 | 664,546 |

6 Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet të tjera

| | 2025 | 2024 (e riparaqitur) |
|---|---------------|----------------------|
| Llogarite e pagueshme | | |
| Furnitoret | 249 | 745 |
| Gjithsej | 249 | 745 |
| Detyrimet tjera | | |
| Detyrimet per kontribute dhe tatime te mbajtura te te ardhurave personale mbi pagat | 11,252 | 12,418 |
| Detyrimet per sherbime te auditimit -akruale | 2,967 | 2,967 |
| Te pagueshmet ndaj punonjesve | 309 | 303 |
| Shpenzimet akruale dhe te tjera | 4,112 | 4,137 |
| Gjithsej | 18,888 | 20,570 |

7 Të hyrat e shtyra

Analiza e balances Me 31 Dhjetor 2025, balanca e të hyrave të shtyra përbëhet si në vazhdim:

| | 2025 | 2024 (e riparaqitur) |
|---|---------------|----------------------|
| | Eur | Euro |
| Te hyrat e shtyra te trajnimit, provimeve anëtarësi | 54,496 | 71,432 |
| Te hyrat e shtyera nga Grantet | 30,000 | 30,000 |
| Gjithsej | 84,496 | 101,432 |

8 Të hyrat

| | 2025 | 2024 (e riparaqitur) |
|---|----------------|----------------------|
| | Euro | Euro |
| Te hyrat nga edukimi | | |
| Regjistrimi | 4,240 | 4,550 |
| trajnimet- sektori privat | 163,127 | 148,822 |
| Provimet- sektori privat | 77,590 | 70,222 |
| Provimet- sektori publik | | |
| Trajnimi-Auditimi I brendshem | 18,620 | 16,890 |
| Provimet-Auditimi I brendshem | 1,440 | 1,140 |
| Trajnimet per specializimet dhe modulet | 39,880 | 5,570 |
| Edukimi I vazhdueshem profesional | 113,220 | 102,790 |
| | 418,116 | 349,984 |
| Te hyrat nga anetarsimi | 125,444 | 122,390 |
| Te hyrat nga kontrolli I cilesise | 63,800 | 60,800 |
| Te hyrat nga Departamenti i konsulences | 6,735 | 14,606 |
| Te hyrat tjera | 22,426 | 22,731 |
| Gjithsej | 636,521 | 570,511 |

9 Shpenzimet administrative

| | 2025 | 2024 (e riparaqitur) |
|---------------------------------|----------------|----------------------|
| | Euro | Euro |
| Pagat | 158,064 | 159,075 |
| Qiraja | 24,260 | 18,800 |
| Sherbimet komunale | 862 | 3,070 |
| Shpenzime te komunikimit | 2,544 | 1,809 |
| Furnizime te zyres | 4,201 | 3,368 |
| Sherbime te auditimit | 2,967 | 4,198 |
| Mirembajtje -renovim I zyres | 310 | 332 |
| Sigurim shendetsore | 2,328 | 1,938 |
| Shpenzimet e reprezentacionit | 737 | 1,879 |
| Shpenzimet e automjetit | 2,554 | 1,810 |
| Orendi dhe Paisje TI | 7,203 | 3,632 |
| Shpenzime tjera | 2,482 | 2,498 |
| Shpenzimet e borxheve te keqija | 3,563 | 2,277 |
| Gjithsej | 212,075 | 204,686 |

10 Shpenzimet e trajnimit

Shpenzimet e trajnimit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2025 dhe 2024 ishin si në vazhdim:

| | 2025 | 2024 (e riparaqitur) |
|---|----------------|----------------------|
| | Euro | Euro |
| Mbajtja e trajnimeve | 77,511 | 78,361 |
| Qiraja | 22,321 | 14,400 |
| Printimi | 5,687 | 7,915 |
| Shpenzimet e rrymes | 119 | 1,249 |
| Te drejtat autoriale BPP, perkthimi dhe azhurnimi | 36,760 | 11,695 |
| Spektori i auditimit te brendshem | 3,164 | 3,466 |
| Specializime - Ekspert Tatimor dhe Forenzike Financiare | 26 | 13 |
| Tjera | 4,406 | 1,768 |
| Gjithsej | 149,993 | 118,867 |

11 Shpenzimet e provimeve

| | 2025 | 2024 (e riparaqitur) |
|-----------------------|---------------|----------------------|
| | Euro | Euro |
| Perpilimi & korigjimi | 7,622 | 9,319 |
| Mbikqyrja | 5,151 | 3,568 |
| Qiraja | 3,300 | 2,645 |
| Printimi | 1,648 | 1,458 |
| Te tjera | 208 | 24 |
| Gjithsej | 17,928 | 17,014 |

12 Shërbimi për anëtarë

| | 2025 | 2024 (e riparaqitur) |
|--|----------------|----------------------|
| | Euro | Euro |
| Edukimi I vazhdueshem profesional | 8,887 | 9,537 |
| Bordi dhe komisionet | 9,256 | 7,088 |
| Udhetimet | 6,817 | 7,790 |
| Takimet vjetore dhe ceremonite | 11,964 | 13,357 |
| Anetarsia ne organizata dhe përfaqesim | 35,614 | 25,600 |
| Seminare dhe punetori | 3,854 | 1,051 |
| Pagat-sherbimi per anetare | 39,212 | 40,971 |
| Menaxhimi i Cilësisë | 31,899 | 42,283 |
| Marketingu | 3,469 | 221 |
| IT dhe Web-faqja | 1,298 | 4,467 |
| Te tjera | 527 | 82 |
| Gjithsej | 152,797 | 152,447 |

*Shpenzimet e Këshillit dhe Komisioneve përfshijnë kompensimet për takime.

13 Shpenzimet e departamentit të konsulencës

| | 2025 | 2024 (e riparaqitur) |
|-------------------------|---------------|----------------------|
| | Euro | Euro |
| Shpenzimet e pagave | 26,545 | 23,922 |
| Shpenzimet e projekteve | 2,592 | |
| Gjithsej | 29,137 | 23,922 |

14 Transaksionet me palët e ndërlidhura

| | 2025 | 2024 (e riparaqitur) |
|---|---------------|----------------------|
| | Euro | Euro |
| Kompensimet per takime te bordit dhe komisione (Shërbimi për anëtarë) | 6,947 | 5,922 |
| Kompensimet lidhur me procesin mësimit | 14,649 | 11,858 |
| Menaxhmenti Kyq | | |
| Paga bruto + kontributi | 42,807 | 50,867 |
| Gjithsej | 64,403 | 68,647 |

15 Zotimet dhe Kontingjentet**Zotimet**

Nuk ka zotime më 31 Dhjetor 2025 përveç marrëveshjes së qirasë së zyrës dhe sallave të trajnimit. Pagesa mujore e qirasë për zyre dhe salla të trajnimeve është 3000 Euro + TVSH.

Çështjet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2025 nuk është llogaritur asnjë provizion për humbjet potenciale në lidhje me çështjet gjyqësore. Menaxhmenti i Organizatës, rregullisht analizon rreziqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me proceset gjyqësore dhe pretendimet e mundshme kundër Organizatës, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mundet gjithmonë të saktësohet, menaxhmenti i Organizatës beson se nuk ka gjasë që të rezultojë ndonjë detyrim material.

16 Ngjarjet pas datës së raportimit


Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që kërkon korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare.

GALERIA











IN MEMORIAM



ISMET UKA
Auditor i Çertifikuar

1961-2025

